



RREGULLORE NR. 2001/25

**MBI LICENCIMIN, MBIKËQYRJEN DHE RREGULLIMIN E KOMPANIVE TË
SIGURIMIT E TË NDËRMJETËSUESVE TË SIGURIMIT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me pushtetin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor të vitit 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të dates 25 korrik 1999, të ndryshuar, të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombevetë Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 1999/20 të datës 15 nëntor të vitit 1999, të ndryshuar, mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës,

Me qëllim të vendosjes së një regjimi ligjor për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimeve nga Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës,

Me anë të kësaj shpall sa vijon:

**KAPITULLI 1
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Termet në e mëposhtëm kuptimet vijuese:

“Sigurim i aksidentit” do të thotë sigurim kundër rrezikut të dëmit si pasojë e një aksidenti.

“Aktuar” do të thotë person i aftësuar profesionalisht i cili është kualifikuar si ekspert i sigurimeve dhe si i tillë është i regjistruar në një organ profesional të pranuar nga BPK-ja.

“Administrator ” do të thotë çdo person i cili është nëpunës ose anëtar i bordit drejtues apo i komisionit mbikëqyrës të një personi juridik dhe çdo person tjetër që është i autorizuar të angazhohet në emër të një personi të tillë.

“Anëtarët” ose “të anëtarësuar” në kontekstin e personit juridik do të thotë se ata konsiderohen “anëtarë” ose “të anëtarësuar” nëse njëri prej tyre e kontrollon tjetrin apo nëse i njëjti person i kontrollon që të dy.

“Agjent” do të thotë personi i cili vepron në emër të një kompanie të sigurimit në përfaqësimin e shërbimeve dhe të produkteve të asaj kompanie.

“Shfrytëzues” do të thotë çdo person i caktuar në një policë sigurimi që gëzon të drejtën e zhdëmtimit në rast të ndodhjes së ndonjë aksidenti.

“Bord i drejtorëve” do të thotë organi i nivelit më të lartë drejtues i korporatës që emërohet me votën e barabartë të aksionarëve.

“BPK” do të thotë Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës.

“Rregull e BPK-së” do të thotë urdhëresë detyruese drejtuar kompanive të sigurimit ose ndërmjetësuesve të sigurimit, që lëshohet nga bordi drejtues për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

“Filial” do të thotë vend i biznesit, përkatësisht një pjesë ligjërisht e varur e një kompanie të sigurimit apo e një ndërmjetësuesi të sigurimit që nuk është posaçërisht i inkorporuar, por që kryen drejtpërdrejt të gjitha punët ose një pjesë të punëve të kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit.

“Broker” do të thotë person i cili vepron në emër të një të siguruari.

“Shoqëri tregtare” do të thotë çdo person ose grup personash që angazhohen në biznes.

“Kapital” do të thotë pasuri (mjete) e luajtshme ose e paluajtshme, e prekshme ose e paprekshme që është në pronësi të një organizate afariste dhe mund të përdoret për krijimin e pasurisë.

“Kapital themelues” do të thotë bashkim i vlerës së përgjithshme të aksioneve që fillimisht duhet të lëshohen nga korporata, siç është deklaruar në dokumentet e saj themeluese.

“Tregti” do të thotë zhvillimi i çfarëdo aktiviteti të qëndrueshëm me qëllim të realizimit të profitit, pavarësisht se a është theksuar një qëllimi i tillë shprehimisht apo jo.

“Sigurim i detyruar” do të thotë sigurim i cili kërkohet të zbatohet sipas ligjit në fuqi në Kosovë.

“Kontroll” mbi një person juridik qoftë vetëm ose në bashkëpunim me një apo me më shumë persona të tjerë do të thotë:

- (a) pronësi e drejtpërdrejtë ose e tërthortë prej 50 për qind ose më shumë e çfarëdo kategorie të aksioneve me të drejtë vote të personit të tillë juridik;
- (b) aftësia për të zgjedhur së paku gjysmën e anëtarëve të bordit të drejtorëve apo të çfarëdo organi ekuivalent, të personit të tillë juridik ose

- (c) aftësia për të ushtruar, pavarësisht nga pronësia formale ose e drejta e votimit, ndikim dominant mbi menaxhmin ose qëndrimet e personit të tillë juridik në baza të një marrëveshjeje ose çfarëdo mënyre tjetër.

“Korporatë” do të thotë shoqëri aksionare ose kompani me përgjegjësi të kufizuar, kapitali i së cilës është i ndarë në një numër të posaçëm aksionesh me vlerë të barabartë dhe aksionarët e të cilës nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e kompanisë.

“Drejtor” do të thotë person fizik i cili ushtron kompetencat e anëtarit të bordit të drejtorëve të korporatës.

“Vit financiar” do të thotë periudha dymbëdhjetë mujore që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

“Sigurim i përgjithshëm” do të thotë i tërë sigurimi, duke përfshirë edhe sigurimin shëndetësor, pos sigurimit të jetës.

“Sigurim shëndetësor” do të thotë sigurim për mbrojtje kundër rrezikut të humbjeve financiare, si pasojë e problemeve shëndetësore.

“Paaftësi paguese” do të thotë një gjendje ku e gjithë pasuria e një kompanie apo e një ndërmjetësuesi të sigurimit, nëse është menjëherë e disponueshme, nuk mund të mjaftojë për t’i shlyer të gjitha detyrimet dhe kur kompania e sigurimit apo ndërmjetësuesi i sigurimit nuk është në gjendje t’i paguajë borxhet që duhet shlyer gjatë rrjedhës normale të biznesit, duke përfshirë pasurinë e cila shpejt mund të shndërrohet në para të gatshme baraz me margjinën e kapitalit minimal të kërkuar dhe margjinën minimale të paaftësisë paguese.

“Rast i siguruar” do të thotë një ngjarje e cila, kur shkaktohet, mund të shkaktojë dhënien e të drejtës për të marrë një kompenzim sigurimi.

“Interes i siguruar” përkitazi me sigurimin e përgjithshëm, do të thotë një interes i një poseduesit të policës apo i një shfrytëzuesi, i cili, nëse dëmtohet ose humb, do t’i shkaktohet dëm poseduesit të policës ose shfrytëzuesit. Përkitazi me sigurimin e jetës, do të thotë një interes në jetën e një apo më shumë personave.

“Sigurim” do të thotë mbrojtje financiare e blerë kundrejt një rreziku të identifikuar potencial të humbjes financiare dhe i evidencuar me anë të policës së sigurimit.

“Kompani sigurimi” do të thotë një person i angazhuar në sigurimin e shërbimeve të poseduesëve të policave

“Zhdëmtim nga sigurimi” do të thotë shumë e paguar nga kompania e sigurimit për poseduesin e policës që rezulton nga një rast i siguruar.

“Ndërmjetësues sigurimi” do të thotë agjent sigurimi, nënagjent ose broker i formuar ose jo ose si korporatë.

“Policë e sigurimit” do të thotë marrëveshje me shkrim ndërmjet një kompanie të sigurimit dhe poseduesit të policës për realizimin e sigurimit.

“Prim i sigurimit” do të thotë shumë e paguar nga poseduesi i policës me qëllim të sigurimit.

“Fondi i Konsoliduar i Kosovës” do të thotë fond i themeluar në pajtim me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/16 të datës 6 nëntor të vitit 1999 mbi themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal të Kosovës dhe çështjet e tjera lidhur me të.

“Licencë” do të thotë autorizim me shkrim i lëshuar nga BPK-ja për kompaninë e sigurimit apo për një ndërmjetësues sigurimi që jep të drejtën për t’u angazhuar në aktivitete të sigurimit siç është saktësuar në Rregullore, rregullat e BPK-së dhe licencën.

“Firma e licencuar e revizionit financiar” do të thotë firmë e cila është e licencuar sipas ligjit në fuqi në Kosovë për të ndërmarrë revizionin financiar.

“Sigurim i jetës” do të thotë polica ose policat kur zhdëmtimi nga sigurimi është i kushtëzuar me vdekjen e personit ose nënkupton pagesën e një rente.

“Dispozitat matematikore” do të thotë dispozita që duhet të llogaritet për policën e sigurimit të jetës. Llogaritja e dispozitave të tilla diktohet nga tabelat e parashkruara të vdekjes dhe faktorët e tjerë. Sipas kësaj rregulloreje, refencat në dispozitat teknike përfshijnë dispozitat matematikore, pos nëse kjo parashihet ndryshe.

“Pasuri pothuajse e gatshme” do të thotë mjete financiare të borxhit afatshkurtër që lehtë mund të tregtohet në afat prej një muaji ose më pak. Ato duhet të klasifikohen A-1, R-1, apo barasvlershëm nga një agjenci ndërkombëtare për klasifikimin e kredisë, e cila është gjerësisht e pranuar dhe të cilës shumica i përmbahen.

“OBZHE” do të thotë Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik.

“Nëpunës” do të thotë person i punësuar nga organi më i lartë drejtues i organizatës së biznesit për të kryer aktivitetet e përditshme të organizatës së biznesit në një pozitë të lartë.

“Urdhër” do të thotë urdhëresë detyruese e BPK-së që i lëshohet një kompanie të sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit ose çfarëdo grupi apo klase që rrjedh prej këndeje në zbatimin e kësaj Rregulloreje apo rregulle.

“Person” do të thotë person fizik ose person juridik.

“Person i lidhur me kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësues i sigurimit” përkitazi me një kompani të veçantë të sigurimit ose ndërmjetësues i sigurimit nënkupton personat e mëposhtëm:

- (a) Çdo administrator në kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësues i sigurimit;
- (b) Çdo zotërues i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që ka një interes të rëndësishëm në kompaninë e sigurimit ose në ndërmjetësuesin e sigurimit;
- (c) Çdo person juridik i cili ka lidhje deri në shokën e dytë qoftë përmes gjakut ose martesës me administratorin apo me zotëruesin e një interesi të rëndësishëm në kompaninë e sigurimit ose në ndërmjetësimin e sigurimit;
- (ç) Çdo person juridik që ka lidhje me kompaninë e sigurimit ose me ndërmjetësuesin e sigurimit;

- (d) Çdo person juridik që ka një administrator i cili njehet është edhe administrator apo zotërues i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i një interesi të rëndësishëm në kompaninë e sigurimit ose në ndërmjetësuesin e sigurimit;
- (e) Çdo person juridik me zotërim të interesit të rëndësishëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, me personin juridik i cili është po ashtu administrator ose zotërues i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i një interesi të rëndësishëm në kompaninë e sigurimit ose në ndërmjetësuesin e sigurimit;
- (ë) Secilin person fizik i cili ka lidhje, deri në shokën e dytë përmes gjakut ose martesës me një administrator ose me një zotërues i një interesi të rëndësishëm në një person juridik që ka lidhje me kompaninë e sigurimit ose me ndërmjetësuesin e sigurimit;
- (f) Secilin person të caktuar nga BPK-ja sipas kësaj rregulloreje që duhet të jetë në lidhje me kompaninë e sigurimit apo me ndërmjetësuesin e sigurimit, bazuar në interesat e përbashkëta të rëndësishme ekonomike me kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësuesin e sigurimit dhe
- (g) Çdo person tjetër në pozitë të ngjashme i caktuar nga BPK-ja si person i afërtë.

“Posedues i policës” do të thotë personi i cili posedon policën e sigurimit.

“Risigurim” do të thotë një person juridik që ofron risigurim.

“Kompani e risigurimit” do të thotë person që ofron risigurimin.

“Transaksion i palëve përkatëse” do të thotë transaksion midis një kompanie të sigurimit ose ndërmjetësuasi të sigurimit dhe personit të lidhur me kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësuesin e sigurimit.

“Banor” do të thotë person me banim të përhershëm në Kosovë, pavarësisht nga shtetësia.

“Nëpunës i lartë” do të thotë nëpunës i rangut më të lartë i një kompanie të sigurimit ose ndërmjetësit të sigurimit.

“Interes i rëndësishëm” do të thotë ose vetëm ose duke vepruar së bashku me personat e tjerë:

- (a) Pronësi e drejtpërdrejtë e 10 për qind ose e më shumë të çfarëdo kategorie të aksioneve me të drejtë vote të personit të tillë juridik ose
- (b) Pavarësisht nga pronësia formale ose të drejtat e votimit, aftësi për të ushtruar një ndikim të rëndësishëm mbi menaxhmentin ose qëndrimet e personit të tillë juridik në bazë të marrëveshjes ose në ndonjë mënyrë tjetër.

“Ndihmës” do të thotë çdo person juridik i kontrolluar nga një person tjetër.

“Nënagjent” do të thotë person i cili vepron në emër të një agjenti të sigurimit, pos një nëpunësi.

“Dispozita teknike” do të thotë dispozita për premitë e pafituara, dëmet e paraqitura, dëmet e shkaktuara por jo të paraqitura, bonuset, zbritjet dhe anulimet.

Neni 2
Fushëveprimi i Rregullores

Kjo Rregullore vlen për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit, aksionarët e tyre, administratorët, punonjësit, agjentët dhe personat e anëtarësuar.

KAPITULLI II
ROLI I BPK-së

Neni 3
Objektivi dhe roli i BPK-së sipas kësaj rregulloreje

3.1 Objektivi kryesor i BPK-së sipas kësaj rregulloreje është mbrojtja e poseduesve të policave, përkatësisht e atyre që blejnë polica të sigurimit nga kompania e sigurimit ose nga ndërmjetësuesit e sigurimit të licencuara në Kosovë.

3.2 Vetëm BPK-ja e ka përgjegjësinë ekskluzive për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit.

3.3 Vetëm BPK-ja e ka përgjegjësinë ekskluzive për caktimin e standardeve dhe nxjerrjen e rregullave, urdhëresave e udhëzimeve lidhur me sjelljen e kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit. Rregullat, urdhëresat dhe udhëzimet e tilla do të publikohen dhe do të hyjnë në fuqi në datën e një publikimi të tillë ose në datat e mëvonshme që përcakton një urdhër apo rregull i tillë.

Neni 4
Autorizimet mbikëqyrëse të sigurimit të BPK-së

BPK-ja në fushën e sigurimit ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) BPK-ja mund t'i vizitojë zyrat e tilla të kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit atëherë kur ajo e konsideron të arsyshme për t'i kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe shënimet e tjera të tilla dhe për të ndërmarrë veprime të tjera nëse e konsideron të nevojshme apo të arsyeshme për ta vënë në jetë qëllimin e kësaj Rregulloreje, ose rregullat apo urdhërat e nxjerra lidhur me të.

b) BPK-ja mund të kërkojë të sigurojë çfarëdo informate nga kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit, duke përfshirë aksionarët ose pronarët e tyre, administratorët dhe punonjësit e tjerë në çfarëdo mënyre që parapëlqehet nga BPK-ja, me kusht që jepet një njoftim i arsyeshëm paraprak.

c) BPK-ja mund të paraqesë ndonjë jë rast në gjykatë dhe të paraqitet vetë para gjykatës kompetente me dokumentacion komplet ligjor për të kërkuar dëmet, të imponojë çfarëdo dënimi jopenal të paraparë në pajtim me këtë Rregullore, apo të pengojë çfarëdo aktesh, praktikash që përbëjnë shkelje të kësaj Rregulloreje ose çfarëdo rregullash të sigurimit, të urdhërave dhe urdhëresave që lë shohen nga BPK-ja dhe

ç) BPK-ja ushtron edhe kompetenca të tjera të parapara me këtë Rregullore ose kompetenca të tjera plotësuese lidhur me zbatimin e një kompetence të paraparë me këtë Rregullore.

Neni 5 Shkallët e sigurimit

BPK-ja me një rregull të saj i definon shkallët e përgjithshme të sigurimit të lejuar.

Neni 6 Sigurimi i detyrueshëm

BPK-ja, përmes rregullave të saj, mund të përcaktojë kushtet e përbashkëta të policave të sigurimit dhe kërkesat e premive për garantimin e sigurimit të detyruar.

Neni 7 Pagesat

7.1 BPK-ja do të kërkojë pagesa për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit për funksionet mbikëqyrëse dhe korrektuese me qëllim që të paguajë shpenzimet e tij të drejtpërdrejta e të tërthorta që shkaktohen në sigurimin e shërbimeve të tilla. Pagesat kompanive të sigurimit do të vlerësohen në raport me shumën e premive neto të shkruara apo të bazuara në çfarëdo shpenzime të jashtëzakonshme që shkaktohen nga BPK-ja apo agjentët e saj në lidhje me aktivitetet e saj mbikëqyrëse që ka të bëjë me një kompani të veçantë të sigurimit.

7.2 Pagesat për ndërmjetësuesit e sigurimit do të llogariten në raport me përqindjen e profiteve të tyre të fituara apo të bazuara në çfarëdo shpenzime të jashtëzakonshme të shkaktuara nga BPK-ja apo agjentët e saj në marrëdhënie me aktivitetet e saj mbikëqyrëse përkritazi me ndërmjetësuesin e veçantë të sigurimit.

7.3 Pagesat do të caktohen sipas një orari të miratuar nga Bordi drejtues i BPK-së dhe do të paguhen brenda dhjetë ditësh të prezantimit të tyre në shpallje nga BPK-ja.

Neni 8 Bashkëpunimi me organet tjera mbikëqyrëse dhe kontrolluese

8.1 BPK-ja do të këmbëjë informata me organet tjera mbikëqyrëse dhe kontrolluese, duke përfshirë autoritetet ndërkombëtare të kontrollimit, me qëllim të nxitjes së zhvillimit harmonik të një rrjeti të saktë institucional të kontrollimit financiar.

8.2 Një organ mbikëqyrës ose kontrollues që kërkon të dhëna nga BPK-ja duhet të saktësojë qartë arsyet e kërkesës së tij. BPK-ja vetëm do të sigurojë informacione në pajtim me kërkesën e tillë në masën sa kërkesa ka të bëjë me çështjet legjitime ligjore mbikëqyrëse.

8.3 Organi mbikëqyrës ose kontrollues siguron të dhëna të hollësishme që mbështesin kërkesën për ato të dhëna. Qëllimi pse kërkohen të dhënat duhet të shpjegohet qartë. Shkeljet e dyshuara të rregulloreve, rregullave, urdhëresave administrative, urdhërave, udhëzimeve dhe

instrumenteve ekvivalente ose çfarëdo forme e tyre duhet do të radhiten sipas një rendi. Sjellja e papërshtatshme e dyshuar dhe veprimet nga ana e kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit dhe aksionarëve, drejtorëve, nëpunësve ose punëtorëve do të identifikohet në mënyrë të ngjashme. Në raste të caktuara, organi mbikëqyrës dhe ai që kërkon duhet t'i sigurojë BPK-së ekstrakte të ligjeve të qeverisjes, rregullore dhe standarde të ngjashme kur organi tjetër mbikëqyrës ose kontrollues dyshon në atë lëshim.

8.4 BPK-ja do të zbulojë informacionin e kërkuar vetëm atëherë kur sigurohet me shkrim nga organi mbikëqyrës ose kontrollues që bën kërkesën se informacioni i tillë kërkohet vetëm me qëllim të kryerjes së detyrave të veta mbikëqyrëse. Për më tepër, informacioni sigurohet vetëm nëse organi mbikëqyrës që bën kërkesën ofron siguri me shkrim, që është e mjaftueshme për BPK-në se ligjet e tij garantojnë kufizimet adekuate ligjore lidhur me transmetimin e një informate të tillë te palët e tjera për qëllime jombikëqyrëse.

8.5 Kur një informatë e kërkuar nga BPK-ja mund të ketë lidhje me çështjet fiskale ose tatimore në një juridiksion tjetër, aty ky është e mundshme, BPK-ja e refuzon kërkesën, pos nëse ekziston një arsye bindëse për ofrimin e informatës, të përcaktuar nga një gjykatë kompetente e Kosovës.

8.6 Kur një organ tjetër mbikëqyrës ose kontrollues dëshiron t'ia transmetojë informatën e siguruar nga BPK-ja një institucioni tjetër mbikëqyrës nën juridiksionin e vet apo gjetiu, së pari duhet të sigurojë lejen nga BPK-ja.

8.7 Dështimi i një organi tjetër mbikëqyrës ose kontrollues për të vepruar në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulloreje do të shfuqizojë çfarëdo marrëveshjeje formale ose joformale për BPK-në për të vazhduar bashkëpunimin me atë palë.

KAPITULLI 3 LICENCIMI, THEMELIMI DHE NDËRPRERJA E PUNËVE

Neni 9 Ndalesat

9.1 Askush nuk mund të angazhohet në biznesin e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit në Kosovë, nëse nuk është licencuar nga BPK-ja.

9.2 Askush nuk mund të përdor fjalën “sigurim” apo ndonjë derivat të fjalës “sigurim” në lidhje me biznesin, emrin e firmës, prodhimin ose shërbimin pa lejen e lëshuar nga BPK-ja. Aq më tepër, askush nuk duhet të bëjë deklaram të rrejshëm për faktet materiale apo për një prezantim të rrejshëm, çorientues apo çkadoqoftë tjetër për të bërë një paraqitje të rrejshme a mashtruese ose të angazhohet me çfarëdo mjeti manipulues apo praktike në lidhje me lëshimin e policave të sigurimit.

9.3 Asnjë person i organizuar jashtë Kosovës nuk duhet të angazhohet në biznesin e kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit në Kosovë përveç nëse aktiviteti ndërmirret nëpërmjet degës apo filialës për të cilën është lëshuar licenca nga BPK-ja.

9.4 Kompania e licencuar për angazhim në sigurimin e jetës nuk duhet të ofrojë asnjë lloj të sigurimit të përgjithshëm.

9.5 Kompania e licencuar për angazhim në çdo lloj të sigurimit të përgjithshëm nuk duhet të ofrojë sigurimin e jetës.

Neni 10

Themelimi i kompanive të sigurimit

11.1 Aplikantët që dëshirojnë të formojnë kompani sigurimi duhet të sigurojnë paraprakisht lejen nga BPK-ja për këtë çështje para formimit të kompanisë së sigurimit.

11.2 Kompania e sigurimit e organizuar sipas ligjit në fuqi do të formohet vetëm si shoqëri aksionare apo si shoqëri aksionare anonime.

Neni 11

Themelimi i ndërmjetësues ve të sigurimit

11.1 Nga ndërmjetësuesi i sigurimit nuk kërkohet të jetë korporatë për t'u licencuar.

11.2 Aplikantët që dëshirojnë për të formuar një ndërmjetësim sigurimi si korporatë në pajtim me ligjin e Kosovës duhet të sigurojnë së pari lejene BPK-së para formimit të ndërmjetësuesit të sigurisë si korporatë.

11.3 Korporata e ndërmjetësimit të sigurimit mund të themelohet vetëm si shoqëri aksionare ose si shoqëri aksionare anonime.

Neni 12

Licencimi i kompanive të sigurimit

12.1 BPK-ja do t'i jep licencë kompanisë së sigurimit vetëm nëse është e kënaqur me plotësimin e minimumit të kushteve të mëposhtme:

(a) Kompania e sigurimit duhet të jetë korporatë e formuar sipas ligjit në fuqi në Kosovë ose degë e korporatës e formuar sipas ligjeve të një legjislacioni tjetër;

(b) Të jetë paguar minimumi i kapitalit të kërkuar;

(c) Nëse plani i biznesit të kompanisë së sigurimit është bazuar në analiza të shëndosha dhe në supozime të arsyeshme;

(ç) Nëse kompani e sigurimit merr përsipër të respektojë dispozitat e kësaj rregulloreje dhe

(d) Nëse kualifikimet, përvoja dhe integriteti i administratorëve të kompanisë së sigurimit, të aksionarëve kryesorë dhe të atyre që propozojnë të kenë ose që kanë interesa të rëndësishme janë adekuate me planin e punës së kompanisë së sigurimit dhe me aktivitetet financiare.

BPK-ja mund të parashtrijë rregulla me të cilat parashihen kushte plotësuese sipas kësaj rregulloreje.

12.2 Brenda tre muajsh nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar për licencë të kompanisë së sigurimit, BPK-ja në mënyrë preliminare do të miratojë ose refuzojë kërkesën dhe do ta njoftojë me shkrim aplikantin për vendimin e marrë; njoftimi për refuzimin do të shpjegojë arsyet në mbështetje të të cilave është refuzuar licenca.

12.3 Në rast të aprovimit preliminar të kërkesës për licencën e kompanisë së sigurimit, BPK-ja do të klasifikojë kushtet për marrjen e licencës së kompanisë së sigurimit për të filluar punët e saj.

12.4 Nëse kompania e sigurimit brenda një viti nuk i plotëson kushtet për të marrë licencën për të filluar punët, afati i miratimit preliminar të kërkesës do të kalojë.

12.5 Kur korporata të jetë formuar në Kosovë me qëllim të aplikimit për licencë të kompanisë së sigurimit, i tërë dokumentacioni themelues i korporatës, duke përfshirë edhe marrëveshjen e themelimit, aktin e themelimit, dispozitat e këtyre ligjeve dhe pajtimin e secilit aksionar apo dokumentacionin ekvivalent, si dhe çdo informacion tjetër pëlotësues që kërkohet nga rregullat e BPK-së duhet të dorëzohet në BPK.

12.6 Akti me të cilin themelohet kompania e sigurimit duhet të përmbajë informacionin lidhur me emrin dhe adresën e korporatës, sasinë e kapitalit themelues, shkallët e aksioneve, numrat dhe vlerat nominale të secilës shkallë të aksioneve dhe të drejtat e votimit që shoqërojnë ato aksione.

12.7 Përveç arsyeve të parashtruara me ndonjë rregull të BPK-së, BPK-ja mund t'ia refuzojë licencën një kompanie të sigurimit nëse heton se interesi i poseduesve të policave të sigurimit nuk do të shërbehet më së miri me miratimin e asaj kërkesë.

12.8 Kompanisë së sigurimit do t'i jepet licenca për një periudhë të pacaktuar kohe dhe nuk do të jetë e transfereueshme.

12.9 Vendimet mbi licencimin e kompanive të sigurimit do të merren në mënyrë të pavarur nga BPK-ja. BPK-ja do të udhëhiqet nga dëshira për të siguruar një treg të shëndoshë e të qëndrueshëm të sigurimit në të cilin nxitet gara e ndershme dhe zgjedhja e klientit.

Neni 13

Licencimi i ndërmjetësuesve të sigurimit

13.1 BPK-ja do t'i jep licencë kompanisë së sigurimit vetëm nëse është e kënaqur me plotësimin e kushteve të mëposhtme:

(a) Nëse është paguar minimumi i kapitalit të kërkuar;

(b) Nëse plani i biznesit të kompanisë së sigurimit është bazuar në analiza të shëndosha dhe në supozime të arsyeshme;

(c) Nëse kompania e sigurimit merr përsipër të respektojë dispozitat e kësaj rregulloreje dhe

(ç) Nëse kualifikimet, përvoja dhe integriteti i administratorëve të kompanisë së sigurimit, aksionarëve kryesorë dhe e atyre që propozojnë të kenë ose që kanë interesa të

rëndësishme janë adekuate me planin e punës së kompanisë së sigurimit dhe me aktivitetet financiare.

BPK-ja mund të parashtrijë rregulla sipas të cilave parashihen kushte plotësuese në përputhje me këtë rregullore.

13.2 Kur korporata të jetë formuar në Kosovë me qëllim të aplikimit për licencë të ndërmjetësuesit të sigurimit, i tërë dokumentacioni themelues i korporatës, duke përfshirë edhe marrëveshjen e themelimit, aktin e themelimit, dispozitat e këtyre ligjeve dhe pajtimin e secilit aksionar apo dokumentacionin ekvivalent, si dhe çdo informacion tjetër pëlotësues që kërkohet nga rregullat e BPK-së duhet të dorëzohet në BPK.

13.3 Për ndërmjetësuesit e sigurimit që janë të integruar, akti i themelimit me të cilin themelohet ndërmjetësuesi i sigurimit si korporatë duhet të përmbajë informacionin lidhur me emrin dhe adresën e korporatës, sasinë e kapitalit themelues, shkallët e aksioneve, numrat dhe vlerat nominale të secilës shkallë të aksioneve dhe të drejtat e votimit që shoqërojnë ato aksione.

13.4 Përveç arsyeve të parashtruar me ndonjë rregull të BPK-së, BPK-ja mund t'ia refuzojë licencën një ndërmjetësuesi të sigurimit nëse heton se interesi i poseduesve të policave të sigurimit nuk do të kruhet më së miri me miratimin e asaj kërkesë.

13.5 Ndërmjetësuesit të sigurimit do t'i jepet licenca për një periudhë të pacaktuar kohe dhe nuk do të jetë e transferueshme.

13.6 Vendimet mbi licencimin e ndërmjetësuesit të sigurimit do të merren nga BPK-ja në mënyrë të pavarur. BPK-ja do të udhëhiqet nga dëshira për të siguruar një treg të shëndoshë e të qëndrueshëm të sigurimit në të cilin nxitet gara e ndershme dhe zgjedhja e klientit.

Neni 14

Lista e miratuar e kompanive të sigurimit dhe e ndërmjetësuesve të sigurimit

BPK-ja do të mbajë shënime, të cilave mund t'iu qaset publiku gjatë orëve të rregullta të punës, që i identifikojnë të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit.

Neni 15

Bazat për anulimin e licencës së kompanisë së sigurimit dhe ndërmjetësuesit të sigurimit

15.1 BPK-ja mund t'ia anulojë licencën pa njoftimin paraprak kur vëfren se:

(a) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit ka dështuar në fillimin e punëve brenda gjashtë muajsh pas dhënies së licencës;

(b) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit vullnetarisht është pajtuar të heqë dorë nga licenca;

(c) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit është në falimentim e sipër ose në procedurën përfundimtare të falimentimit në baza vullnetare ose jovullnetare;

(ç) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit shkelin kufijtë ose kushtet e përfshira në licencën e tij të lëshuar nga BPK-ja;

(d) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit ka nënshkruar biznes tjetër sigurimi nga ai për të cilin është i licencuar nga BPK-ja;

(dh) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit nuk e zhvillon biznesin e tij në pajtim me parimet e shëndosha të sigurimit e të punës;

(e) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit kryen biznesin në mënyrën e tillë që është e dëmshme për poseduesit e policave;

(ë) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit nuk është në përputhje me këtë rregullore apo me instrumentet ndihmëse të lëshuara me të, të cilat sipas vlerësimit të BPK-së përbëjnë shkelje të tillë serioze që shpiejnë drejt problemeve të mëdha financiare dhe drejt falimentimit të kompanisë së sigurimit;

(f) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit qëllimisht ka shkelur dispozitat e kësaj rregulloreje;

(g) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit nuk e ka përmirësuar lëshimin e detajizuar në urdhërinë e BPK-së brenda afatit të caktuar nga BPK-ja;

(gj) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit qëllimisht dhe seriozisht ka shkelur dispozitat e çdo rregulloreje apo të ligjit në fuqi;

(i) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit adopton një emër i cili ka për qëllim të çorientojë shoqërinë në Kosovë;

(j) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit është i paaftë për të paguar dëmet në kohën e duhur;

(k) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit është i paaftë të paguajë detyrimet me lëshime, sipas radhës që paraqitën;

(l) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit me qëllim ka ofruar informacion të rrejshëm ose çorientues për poseduesit e policave ose për BPK-në;

(ll) Secili prej aksionarëve, drejtorëve, zyrtarëve ose punëtorëve të kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit e sigurimit në mënyrë jo të duhur kanë ndikuar në garantimin ose në aktivitetet investuese të kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit në mënyrë të tillë që ka gjasë të jetë e dëmshme për interesat e poseduesve të policave;

(m) Secili prej aksionarëve, drejtorëve, zyrtarëve ose punëtorëve të kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit e sigurimit bindshëm janë të dyshuar të jenë angazhuar në aktivitete mashtruese;

(n) Kompania e sigurimit e përfundon marrëveshjen e agjencisë me një nga agjentët. Në rastin e tillë, kompania e sigurimit menjëherë duhet ta njoftojë BPK-në për qëllimin e përfundimit të asaj marrëveshjeje dhe BPK-ja menjëherë do të anulojë licencën e atij agjenti dhe të të gjithë nënagjentëve të saj dhe

(nj) Mbi çdo baze tjetër që është në kundërshtim me qëllimet e parashtruara të kësaj rregulloreje.

15.2 BPK-ja po ashtu mund të anulojë licencën pa njoftimin paraprak kur vendos në mbështetje të një raport autoritativ të ekspertit të sigurimit, në mbështetje të një mendimi autoritativ nga dispozitat e ekspertit të dëmeve ose përmes mënyrave të tjera se një kompani e sigurimit ose ndërmjetësues i sigurimit ka gjasë të jetë i falimentuar.

15.3 Nëse licenca e kompanisë së sigurimit anulohet, BPK-ja po ashtu do të anulojë menjëherë licencën e të gjithë agjentëve dhe nënagjentëve që punojnë për kompaninë e sigurimit.

15.4 BPK-ja me lirinë e saj apo me urdhërin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm mund ta kthejë anulimin e licencës së një kompanie të sigurimit ose ndërmjetësuesi të sigurimit.

Neni 16

Efkti i anulimit të licencës së kompanisë së sigurimit ose kompanisë së ndërmjetësimit

Pas anulimit të licencës së saj, kompania e sigurimit ose kompania ndërmjetësuese e sigurimit do të vendoset nën administrim ligjor sipas kapitullit mbi administrimin ligjor të parashtruar në këtë rregullore.

Neni 17

Publikimi i anulimit të licencës

Vendimi i BPK-së për të anuluar licencën e kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit do t'i dorëzohet kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit dhe ai publikohet në një a në më shumë gazeta të qarkullimit të gjerë në Kosovë.

Neni 18

Tërheqja nga tregu i sigurimit në Kosovë

18.1 Nëse një kompani e sigurimit e organizuar jashtë Kosovës ka për qëllim të tërhiqet nga tregu i Kosovës, ajo duhet ta kërkojë miratimin paraprak nga BPK-ja. Pas pranimit të miratimit të BPK-së dhe para tërheqjes nga tregu i Kosovës, kompania e tillë duhet t'i ofrojë BPK-së dëshmi të mjaftueshme se të gjitha dëmet e poseduesve të policave të saj janë paguar nga kompania ose se ato janë transferuar në përgjegjësinë e një kompanie tjetër të sigurimit të licencuar nga BPK-ja me pranimin paraprak të BPK-së.

18.2 Kompania e sigurimit e cila kërkon ta lëshojë tregun e Kosovës pa e bërë transferin e policave e ndërpret mbështetjen e policave të reja të sigurimit si dhe vazhdimin e policave ekzistuese të sigurimit një vit para datës së propozuar të tërheqjes. Pas kalimit të periudhës njëvjeçare, kompania duhet t'ia dërgojë me postë njoftimin poseduesve të vet të policave për qëllimin e tërheqjes nga tregu i Kosovës dhe duhet ta publikojë këtë njoftim në një gazetë të Kosovës me qarkullim të gjerë një herë në javë brendapërbrenda katër javëve. Njoftimi duhet të shpallë qartazi se kompania ka për qëllim të tërhiqet nga tregu i sigurimit i Kosovës dhe se të gjitha dëmet e shkaktuara poseduesve të saj të policave ende të paparaqitura në kompani duhet të regjistrohen jo më vonë se tre muaj pas datës së publikimit të njoftimit final në gazetë.

18.3 BPK-ja vendosë në bazë të informatave që i sigurohen asaj sipas këtij neni ose në bazë të raportit të një eksperti të pavarur të sigurimit apo të mendimit të një revizioni për dëmet e kërkuara të bëra nga një ekspert i paguar i kompanisë që largohet për shumën që kompania duhet t'ia transferojë BPK-së për ta përdorur si fond special për mbulimin e arsyeshem të detyrimeve të mbetura të kompanisë së sigurimit e cila tërhiqet. Fondi special për detyrimet e kompanisë së sigurimit i cila tërhiqet duhet të ndahet nga llogaritë e tjera bankare të BPK-së. Nëse, bazuar në këtë procedurë, BPK-ja është e kënaqur me faktin se të gjitha dëmet janë paguar, atëherë do t'ia lëshojë kompanisë së sigurimit në tërheqje e sipër, ose trashëguesve të saj, shumën e mbetur në fondin special.

18.4 As kompania e sigurimit në tërheqje e as BPK-ja nuk janë përgjegjëse për të paguar dëmet e regjistruara nga poseduesit e policave të cilët nuk i regjistrojnë dëmet e tyre brenda periudhës së theksuar tremujore pas njoftimit final në gazetë.

KAPITULLI IV NDËRMJETËSUESIT E SIGURIMIT

Neni 19 Agjentët

19.1 Roli i agjentit është të shesë produktet e sigurisë dhe shërbimet që janë më të përshtatshmet për nevojat e poseduesve të policave. Agjentët do të paguhet me anë të komisionit apo me anë të pagës fikse, apo sipas të dy mënyrave, nga kompania e sigurimit të cilën ata e përfaqësojnë.

19.2 Agjentët nuk duhet të veprojnë në emër të më shumë se një kompanie të sigurimit. Marrëdhënia do të evidencohet me anë të kontratës me shkrim midis kompanisë së sigurimit dhe agjentit në dispozicion për shqyrtim nga BPK-ja në vend gjithë kohën qoftë në kompani, qoftë në objektin e agjentit. Kontrata në mënyrë specifike do të parshtrijë kompetencat e agjentit që punon për kompaninë e sigurimit dhe shprehimisht do të përfkufizojë veprimet e agjentit për të cilin kompania e sigurimit do ta marrë përgjegjësinë.

19.3 Agjentët duhet të mbajnë vazhdimisht listën e nënagjentëve të autorizuar dhe ajo mund të shihet nga BPK-ja në çdo kohë.

Neni 20 Nënagjentët

20.1 Nënagjentët nuk duhet të veprojnë në emër të më shumë se një agjenti të sigurimit në të njëjtën kohë. Marrëdhënia duhet të evidencohet me anë të kontratës me shkrim midis agjentit të sigurimit dhe nënagjentit. Ajo kontratë duhet të parashtrijë qartazi të drejtat, obligimet dhe fushën e autorizimeve të nënagjentit në mënyrë që të minimizojë përgjegjësinë e kontestit në një datë vijuese.

20.2 Nënagjentët mund të paguhet nga agjentët e sigurimit që i përfaqësojnë me përqindje ose me pagë fikse, apo në të dyja format.

Neni 21
Komisionerët

21.1 Komisioneri është i ngarkuar me sigurimin e policës së sigurimit të vlerës më të mirë e më të përshtatshme për nevojat e poseduesve të policave. Komisionerët do të paguhen me përqindje nga kompania e sigurimit për të cilën i shesin policat e sigurimit.

21.2 Komisionerët duhet të mbajnë në vazhdimësi listën e kompanive të sigurimit për të cilat komisioneri është i autorizuar të veprojë dhe kjo mund të shihet në çdo kohë nga BPK-ja.

Neni 22
Çështjet e ndërmjetësimit të sigurimit

22.1 Kompania e sigurimit do të jetë përgjegjëse për të gjitha transaksionet e sigurimit në të cilat hyn me anë të agjentëve të saj të autorizuar dhe së këndejmi edhe për nënagjentët që punojnë për ata agjentë në pajtim me kushtet e marrëveshjes me agjencinë dhe nënagjencinë e nënagjentët.

22.2 Komisioneri i sigurimit do të jetë përgjegjës ndaj poseduesve të policave për humbjet që pësojnë poseduesit e policave në rastet kur ato humbje shkaktohen nga pakujdesia ose përfaqësimi i gabuar i komisionerëve të sigurimit.

22.3 Nënagjentët duhet t'i sigurojnë BPK-së konfirmimin vjetor me shkrim nga agjenti për të cilin janë të autorizuar për të vepruar.

22.4 Ndërmjetësuesi i sigurimit duhet t'i njoftojë poseduesit potencialë të policave kur ndërmjetësuesi përfaqëson kompaninë e sigurimit.

22.5 Fshehja e qëllimshme e premive të garantuara ose të mbledhura nga ndërmjetësuesi i sigurimit do ta vë atë ndërmjetësues të sigurimit nën sanksione të parashtruara me këtë rregullorë ose nën rregullat apo urdhëresat e BPK-së.

Neni 23
Obligimet e ndërmje tësuesve të sigurimit

Ndërmjetësuesitë e sigurimit duhet:

(a) Të zbulojnë qartazi të gjithë informacionin lidhur me marrëdhënien e tyre me kompaninë e sigurimit ndaj poseduesit potencialë të policës së sigurimit;

(b) Të njoftojnë poseduesin potencial të policës për emrin e kompanisë së sigurimit, kushtet dhe rrethanat e politikës së sigurimit, shumat e duhura të premive, mbulesën e siguruar dhe përjashtimet e përgjithshme apo të veçanta;

(c) Të ofrojnë mjaft informacion për të përpiluar profilet e sakta të poseduesve potencialë të policave që shpiejnë nga vlerësimi i besueshëm i nevojave të poseduesve potencialë të policave;

- (ç) Të jetë në gjendje që menjëherë të arsyetojë këshillën për ofrimin e një poseduesi potencial të policës;
- (d) Veprojnë në interesin më të mirë të poseduesve potencialë të policave përmes zbatimit të kujdesit të nevojshëm, profesionalizmit dhe zellin të përkushtimit në çështjet e biznesit;
- (dh) Sillen me integritet të pacënuar dhe me barazi ndaj poseduesve potenciale dhe atyre ekzistues të policave të sigurimit;
- (e) Dërgojë menjëherë shumat e duhura kompanisë së sigurimit.

Neni 24

Kushtet financiare të komisionerëve të sigurimit

24.1 Komisioneri i sigurimit duhet të sigurojë dëshmi për mundësinë e mjaftueshme financiare pranë BPK-së para se të marrë licencën për të realizuar biznesin. Komisionerët së pari duhet të sigurojnë kompenzimin profesional të policës së sigurimit nga kompania e licencuar e sigurimit ose një garancion financiar të pakusht nga BPK-ja – banka e miratuar. Të dyja format e mbulesës do t'i nënshtrohen njoftimit njëmuajor të anulimit. Shuma e mbulesës e siguruar do të jetë e barabartë me shumën e premise së sigurimit të biznesit të paraparë nga aplikanti për licencën e komisionerit.

24.2 Kompenzimi profesional i sigurimit ose garancioni bankar duhet të mbulojë aktivitetet profesionale të komisionerit në minimum për një vit. Nëse zëvendësimi i kompenzimit profesional të sigurimit ose zëvendësimi i garancionit bankar nuk rregullohet me shkrim dhe nuk konfirmohet në BPK së paku një muaj para datës së anulimit të planifikuar të kompenzimit profesional të policës së sigurimit apo garancisë bankare të pakusht, BPK-ja do të ketë autorizimin për të pezulluar licencën e komisionerit dhe të ndalojë garantimin e mëtejshëm të sigurimit. Licenca e komisionerit mund të ripërtëritet vetëm kur komisioneri sërish siguron mbulesën për kompenzimin profesional të sigurimit ose garancionin bankar të pakusht së paku për një kohëzgjatje njëvjeçare.

24.3 BPK-ja mund të parashtrijë rregulla me të cilat parashihen kushte plotësuese sipas kësaj rregulloreje.

KAPITULLI V MBIKËQYRJA

Neni 25

Monitorimi dhe kontrollimi

25.1 Çdo kompani e sigurimit dhe ndërmjetësues i sigurimit si dhe filialat e tyre i nënshtrohen monitorimit nga BPK-ja, që përfshin rishikimin e gjendjeve financiare dhe të raporteve të tjera të dorëzuara BPK-së nga kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit.

25.2 Çdo kompani e sigurimit dhe ndërmjetësues i sigurimit si dhe filialat e tyre i nënshtrohen kontrollimeve nga kontrolluesit e BPK-së apo nga ndonjë firmë e revizionit financiar e caktuar nga BPK-ja. Kontrolluesit e tillë mund të përfshijnë zyrtarë të autoritetit të

një vendi tjetër që është i ngarkuar me mbikëqyrjen e kujdeshme të aktiviteteve të sigurimit në atë vend kur kompania e sigurimit është degë ose filialë e kompanisë së sigurimit të mbikëqyrrur nga organi mbikëqyrës ose kontrollues i vendit tjetër.

Neni 26

Mbajtja e shënimeve

26.1 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të mbajnë shënime të plota e të sakta në objektet e tyre për të lehtësuar kontrollimet efikase të BPK-së. Ky kusht vlen lidhur me të gjitha shënimet e tashme dhe shtrihet deri në pesë vitet e përparshme financiare. Ky kusht përfshin, por nuk kufizohet me kaq, aktin themelues dhe dispozitat apo dokumentacionin ekvivalent, regjistrin e premisë, regjistrin e dëmeve, librin e llogarive, marrëveshjet e risigurimit, procesverbalet e takimeve të bordit të drejtorëve, listën e pertëritur të agjentëve të autorizuar, gjendjet financiare dhe deklaratat e filialave dhe programet, librat e punës së kontrollit të brendshëm financiar dhe raportet, listën e drejtorëve dhe detajet e kontaktit me ta, por dhe listën e aksionarëve dhe numrin e aksioneve që mbahen nga secili aksionar si dhe detajet e kontakteve me ta.

26.2 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit mund t'i mbajnë shënimet e tyre në formë elektronike nëse atyre lehtë mund t'iu qasen revizorët financiarë të brendshëm e të jashtëm dhe kontrolluesit e BPK-së. Shënimet elektronike duhet të ruhen në kopje rezervë në baza ditore. Kopjet e shënimeve elektronike duhet të mbahen në një vend jashtë, pra në një vend të sigurt.

26.3 Si shënimet në objekt ashtu edhe ato jashtë objektit, në letër apo në formë elektronike, duhet të jenë të siguruar nga zjarri, vjedhja, dëmtimi, uji, sabotazha dhe nga rreziqet e tjera potenciale të shkatërrimit.

26.4 Ashtu siç është përdorur në këtë nen, "shënime" do të thotë i tërë dokumentacioni në lidhje me premitë, dëmet dhe investimet, duke përfshirë raportet e brendshme dhe të jashtme, korrespondencën dhe çdo informacion tjetër që BPK-ja e konsideron të nevojshëm për kontrollin e kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësimit të sigurimit nga revizori financiar i brendshëm a i jashtëm ose nga BPK-ja.

KAPITULLI VI ÇËSHTJET E KUJDESIT

Neni 27

Kapitali minimal - margjina e aftësisë paguese

Kompania e sigurimit duhet të mbajë gjithë kohën kapitalin margjinën e kapitalit minimal-aftësisë paguese në pajtim me rregullat e BPK-së.

Neni 28

Kushti i rezervës

28.1 Kompanitë e sigurimit të përgjithshëm duhet të mbajnë aktiva në të holla të gatshme apo pothuajse të gatshme në vlerë të një pjese të provizioneve të tyre teknike në llogari rezervë, siç është parashtruar përmes rregullave të BPK-së.

28.2 Nga kompanitë e sigurimit të jetës kërkohet të mbajnë një pjesë të dispozitave të tyre teknike, siç është përcaktuar nga eksperti i sigurimeve i pranueshëm për BPK-në, në një llogari rezervë, siç është parashtruar përmes rregullave të BPK-së.

28.3 Llogaria rezervë duhet të mbahet në BPK apo në një bankë të miratuar nga BPK-ja.

Neni 29

Limiti mbi premitë neto të shkruara për kompanitë e sigurimit

29.1 BPK-ja, me anë të rregullës së BPK-së, do të caktojë limitet lidhur me shumën e premive neto që kompania e sigurimit mund të shkruajë. BPK-ja mund t'i lëshojë urdhër kompanisë së veçantë të sigurimit për të plotësuar standarde më strikte se sa ato të parashtruara me një rregull të BPK-së.

29.2 Sa më shpejt që kompania e sigurimit bëhet e vetëdijshme se mund të mos mbesë në pajtim me limitet e parashtruara sipas këtij neni, menjëherë do të njoftojë BPK-në mbi shkeljen e pritur dhe planet për të përmirësuar shkeljen e nenit në kohën e duhur.

Neni 30

Limiti i ekspozimit të kompanisë së sigurimit ndaj një ngjarjeje të vetme të siguroeshme

Kompania e sigurimit duhet të sigurojë se humbja maksimale që shkaktohet nga një ngjarje e vetme e siguroeshme nuk do të kalojë shumën e caktuar me rregullën e BPK-së. Kompania e sigurimit duhet të marrë masa që më parë lidhur me risigurimin e shumave që tejkalojnë këtë shumë me kompanitë e sigurimit të pranueshme për BPK-në.

Neni 31

Limiti i pagesave të pjesëve nga fitimi

Asnjë pjesë e fitimit nuk mund të shpërndahet nga kompania e sigurimit ose kompania ndërmjetësuese e sigurimit pa miratimin paraprak me shkrim nga BPK-ja. BPK-ja mund të refuzojë kërkesën për të shpërndarë pjesët nga fitimi nëse sipas vlerësimit të saj pagesa e pjesëve të fitimit rrezikon të dobësojë margjinën e kapitalit - aftësisë paguese të kompanisë së sigurimit ose kompanisë ndërmjetësuese të sigurimit që kërkohet me rregullat e BPK-së ose me pozitën financiare të kompanisë ndërmjetësuese të sigurimit.

Neni 32

Likuiditeti dhe përputhja e pasurisë me përgjegjësinë

32.1 Kompania e sigurimit duhet të sigurojë se ka fonde në dispozicion gjatë gjithë kohës për t'i paguar dëmet e posedusve të policave të saj në kohën e duhur dhe për të paguar kreditorët e saj në kohën e kthimit të borxheve.

32.2 Kompania e sigurimeve dhe ndërmjetësuesi i sigurimeve duhet të kujdesën që të harmonizojnë në mënyrë adekuate maturitetin e pasurisë së tyre me detyrimet e tyre.

32.3 BPK-ja mund të parashtrtojë limite me anë të një rregulle të BPK-së lidhur me shumën e mjeteve financiare që mund të investohen në çdo lloj pasurie.

Neni 33

Riblerja ose anulimi i aksioneve nga kompania e sigurimit ose nga kompania ndërmjetësuese e sigurimit

Kompania e sigurimit ose kompania ndërmjetësuese e sigurimit që kërkon riblerjen ose anulimin e cilitdo prej aksioneve të saj të lëshuara ose të papaguara, së pari duhet të sigurojë miratimin e BPK-së.

Neni 34Vlerësimi i pasurisë

Vlerësimi i pasurisë së një kompanie sigurimi ose një ndërmjetësuesi të sigurimit bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe sipas udhëzimeve të përcaktuara me një rregull të BPK-së.

Neni 35Përgjegjësitë

35.1 Njësitë e mëposhtme duhet të merren parasysh lidhur me përgjegjësitë dhe qëllimet e llogaritjes për kompaninë e sigurimit:

- (a) Dispozita për dëmet e shkaktuara dhe të raportuara, por të papaguara;
- (b) Dispozita për dëmet e shkaktuara, por të paraportuara;
- (c) Dispozita për premitë e pafituara dhe
- (ç) Shumat e duhura për kreditorët.

35.2 BPK-ja mund t'i lejojë kompanisë së sigurimit të reduktojë përgjegjësitë lidhur me shumat e borxheve nga kompanitë e risigurimit, bazuar në vlerësimin realist të probabilitetit të pagesës nga ato kompani të risigurimit.

Neni 36Ndryshimet në plane t e biznesit

Ndryshimet e rëndësishme në planin e biznesit të një kompanie të sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit duhet t'i dorëzohen BPK-së për miratim paraprak. Miratimi i ndryshimeve të rëndësishme mund të parashtrohet me një urdhëresë të BPK-së.

Neni 37Shitja ose transferi i biznesit

37.1 Shitja ose transferi i biznesit nga një kompani e sigurimit ose nga ndërmjetësuesi i sigurimit të tjetri e kërkon miratimin paraprak të BPK-së.

37.2 Kur kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit kërkon nga BPK-ja miratimin për shitje ose transfer të një pjese apo të tërë biznesit të tij një kompanie tjetër ose një ndërmjetësuesi tjetër, BPK-ja duhet të marrë parasysh ndikimin e margjinës së kapitalit

minimal - e aftësisë pagueuse të kompanisë së sigurimit ose ndikimin financiar në ndërmjetësuesin e sigurimit që merr atë biznes të sigurimit.

37.3 Të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga policat e sigurimit të shituara ose të transferuara duhet të përcillen në kompaninë pranuese të sigurimit ose në ndërmjetësinë e sigurimit pas marrjes së miratimit nga BPK-ja për shitje ose transfer të aksioneve të policave të sigurimit.

37.4 Kompania pranuese e sigurimit ose ndërmjetësi i sigurimit duhet të informojë poseduesit e policave që ndikohen nga shitja ose transferi i policave të tyre te një kompani tjetër e sigurimit ose ndërmjetësues i sigurimit. Njoftimi i tillë i poseduesve të policave të ndikuar do t'iu ofrojë atyre opcionin për të anuluar dhe aranzhuar mbulesën e sigurimit me një kompani alternative të sigurimit ose përmes një ndërmjetësuesi alternativ të sigurimit brenda 30 ditësh të pranimit të njoftimit për transfer.

Neni 38

Ndryshimet në pronësi, shkrirja dhe bashkimi i firmave

38.1 Transaksionet e mëposhtme kërkojnë miratimin paraprak me shkrim të BPK-së të:

(a) Çfarëdo transaksioni që mund të rezultonte në personin i cili merr një interes të rëndësishëm në kompaninë e sigurimit ose në ndërmjetësuesin e sigurimit dhe

(b) Çfarëdo transaksioni i cili do të ndryshonte madhësinë e interesit të rëndësishëm të personit në kompaninë e sigurimit ose në ndërmjetësuesin e sigurimit.

38.2 Çfarëdo propozimi për të shkrirë ose bashkuar një a më shumë kompani të sigurimit ose ndërmjetësues të sigurimit duhet të marrë miratimin e BPK-së para transaksionit të propozuar.

Neni 39

Ndryshimet në revizionin financiar të firmës, ekspertët e sigurimit, drejtorët ose nëpunësit

39.1 Kur kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit ka për qëllim të ndryshojë revizorin financiar të firmës ose ekspertin e sigurimeve, kompania ose ndërmjetësuesi duhet të sigurojnë miratimin paraprak me shkrim nga BPK-ja.

39.2 Ndryshimet në bordin e drejtorëve ose nëpunësve të kompanive të sigurimit apo të ndërmjetësuesve të sigurimit duhet t'i raportohen dhe t'i shpjegohen BPK-së.

Neni 40

Ndryshimi i emrit të kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësit të sigurimit

Kur kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit propozon ndryshim të emrit, kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit duhet të sigurojë miratimin paraprak të BPK-së. Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit duhet të njoftojë poseduesit e vet të policave për ndryshimin e emrit pas marrjes së miratimit nga BPK-ja.

Neni 41
Risigurimet

Kompanitë e sigurimit duhet të sigurojnë miratimin për programet e tyre të risigurimit nga BPK-ja. Ndryshimet e mëdha në program, siç janë partnerët e rinj të risigurimit ose tipat e ndryshëm të mbulesës së risigurimit duhet t'i nënshtrohen shikimit paraprak dhe miratimit nga BPK-ja. BPK-ja mund të përcaktojë udhëzime dhe kufizime mbi programet e risigurimit përmes rregullave të BPK-së.

Neni 42
Produktet derivuese financiare

Kompanitë e sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit nuk duhet të hyjnë në asnjë transaksion financiar që përfshin prodhime derivuese siç janë mundësitë, optionet, këmbimet dhe dërgesat ose variacionet mbi po ato produkte pa miratimin paraprak të BPK-së. BPK-ja duhet të përcaktojë në një rregullore të BPK-së udhëzimet dhe kushtet sipas të cilave kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit mund të hyjnë në transaksione të tilla financiare.

Neni 43
Interesat e sigurisë dhe huazimi i pasurisë

Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit mund të krijojë vetëm pengim prone si garanci pagese apo të huazojë pasuri pas miratimit paraprak të BPK-së.

Neni 44
Nënkontraktimi

Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit nuk mund të angazhohet jashtë aktivitetit kryesor të punës operative të sigurimit siç është vlerësimi i rrezikut dhe nënshkrimi i rrezikut, mbledhja e premisë dhe e dëftesave, raportimi i dëmeve, pagesa e dëmeve dhe investimi i të hyrave të pranuar. Puna rreth verifikimit dhe rregullimit të dëmeve mund të nënkontraktohen. BPK-ja mund të përcaktojë, me anë të një rregulle të BPK-së, kushtet dhe kufizimet e mëtejme lidhur me angazhimin e jashëm.

Neni 45
Mbajtja e pasurisë në Kosovë

45.1 BPK-ja mund të përcaktojë, me anë të rregullës së BPK-së, kushtet për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit lidhur me mbajtjen e mjeteve financiare brendapërbrenda Kosovës.

45.2 Degët e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të mbajnë pasuri të mjaftueshme brenda Kosovës për të mbuluar përgjegjësitë e tyre.

Neni 46
Kufizimet për aktivitetet josiguruese

46.1 Kompanitë e sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit nuk duhet të angazhohen në çfarëdo biznesi tjetër pos atij të sigurimit dhe në aktivitete të tjera të lidhura me sigurimin pa autorizim paraprak të BPK-së.

46.2 Kompanitë e sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit, poseduesit e një interesi të rëndësishëm në kompanitë e tilla, drejtorët e tyre, nëpunësit ose punëtorët nuk mundën ndarazi ose kolektivisht të investojnë në më shumë se dhjetë për qind të aksioneve të barabarta të çfarëdo biznesi që nuk ka të bëjë me sigurimin ose në lidhje me sigurimin pa miratimin paraprak të BPK-së. BPK-ja mund të lëshojë një rregull të BPK-së me të cilën përcaktohen kushtet dhe rrethanat e investimeve që tejkalojnë dhjetë për qind.

Neni 47

Aktivitetet në lidhje me sigurimin

47.1 Kompania e sigurimit mund të zhvillojë aktivitete në lidhje me sigurimin.

47.2 Aktivitetet që kanë lidhje me sigurimin përfshijnë sa vijon:

- (a) Verifikimin e dëmeve dhe shërbimet e rregullimit;
- (b) Qendrat e riparimit dhe shërbimet e zvogëlimit të rrezikut;
- (c) Qendrat e vlerësimit dhe
- (ç) Pajisjet e sigurimit për arsimim dhe aftësim.

47.3 BPK-ja mund të aprovojë rregulla plotësuese lidhur me aktivitetet e ngjashme të sigurimit në përputhje me këtë rregullore.

KAPTNINA VII FAKTORËT FINANCIARË

Neni 48

Standardet e llogaritjes dhe shënimet

48.1 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të përgatisin gjendjet financiare në pajtim me standardet ndërkombëtare të llogaritjes.

48.2 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të mbajnë shënime dhe sisteme adekuate të llogaritjes, duke përfshirë regjistrin e primeve, librin e primeve, raportet e primeve, regjistrin e dëmeve, librin e llogarive dhe librin e përgjithshëm në pajtim me rregullat e BPK-së.

Neni 49

Revizioni i jashtëm financiar

49.1 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të kenë gjendjet e tyre financiare të revizionuara në baza vjetore nga një firmë e licencuar e revizionit financiar.

49.2 Caktimi i firmës së revizionit i nështrohet miratimit paraprak me shkrim nga BPK-ja. Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit duhet të sigurohet se firma e revizionit financiar është profesionalisht e kualifikuar për të marrë rolin e revizionit. BPK mund të refuzojë caktimin e firmës së revizionit financiar nëse BPK-ja nuk është e bindur se firma e revizionit nuk ka njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në revizionimin e kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit.

49.3 Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit mund hyjë në marrëveshje me shkrim për angazhimin e firmës lidhur me revizionin financiar. Firma e revizionit financiar nuk bën të jetë person që ka lidhje me kompaninë e sigurimit ose me ndërmjetësuesin e sigurimit.

49.4 Firma e revizionit financiar duhet të:

(a) Shqyrtojë përshtatshmërinë e revizionit financiar të brendshëm dhe praktikave të kontrollit të brendshëm, të njoftojë për mungesat dhe të bëjë rekomandime për përmirësim;

(b) Shpreh mendimin nëse gjendjet financiare paraqesin një pasqyrë reale dhe korrekte e të drejtë të gjendjes financiare dhe të aktivitetit të kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit në pajtim me standardet ndërkombëtare të llogaritjes dhe

(c) Paraqesë një raport të revizionit financiar dhe konstatimet e bordit të drejtorëve të kompanisë së sigurimit ose kompanisë ndërmjetëse të sigurimit.

49.5 Përveç tjerash, marrëveshja për angazhimin e firmës së revizionit financiar duhet të saktësojë se firma e revizionit financiar duhet ta shprehë mendimin se a është një kompani e sigurimit apo një ndërmjetësues i sigurimit në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe rregullat në fuqi të miratuara nga BPK-ja.

49.6 Pos kësaj, marrëveshja për angazhimin e firmës së revizionit financiar duhet të kërkojë nga firma e revizionit financiar që t'i raportojë drejtpërdrejt BPK-së sa më shpejt që të jetë e mundur, sapo të kuptojë për ndonjë nga veprimet vijuese:

(a) Një veprim mashtrues të kryer nga ndonjë punëtor i kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit apo cilado nga filialët ose çfarëdo parregullsie ose mungese në administrimin apo veprimet e saj, që me arsye pritet se mund të rezultojë në humbje materiale të kompanisë;

(b) Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit në mënyrë sistematike i kundërvihet kësaj rregulloreje ose rregullave të BPK-së dhe

(c) Konkluzat e raportit të revizionit financiar fshihen, injohoren ose në mënyrë joadekuatë ndikohen nga menaxhmenti apo bordi i drejtorëve të kompanisë së sigurimit.

49.7 BPK-ja mund të parashtrijë rregulla me të cilat përcaktohen aktivitetet plotësuese në pajtim me këtë Rregullore.

50.1 Fundi i vitit financiar për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit është 31 dhjetori. Pasqyrat financiare të revizionuara dhe të bashkuara, të përgatitura me përdorimin e standardeve ndërkombëtare të llogaritjes duhet të dorëzohen jo më vonë se 30 prilli i vitit pasues financiar.

50.2 Pos kësaj, secila kompani e sigurimit dhe ndërmjetësuesi i sigurimit duhet të përgatisin dhe t'i dorëzojnë BPK-së raporte tremujore lidhur me administratën e saj dhe veprimet e sigurisë, likuiditetin, aftësinë paguese dhe profitabilitetin si dhe ato të filialave në baza individuale dhe të bashkuara. Raportet duhet të përgatiten në formë dhe në hollësi të tillë si dhe duhet të dorëzohen në intervale të tilla siç parashtrohet me rregulla të BPK-së.

Neni 51

Kushtet për ekspertët e sigurimit ose dispozitat për verifikimin e dëmeve

51.1 Kompanitë e sigurimit të jetës duhet t'i dorëzojnë firmës së revizionit financiar dhe BPK-së një certifikatë të saktë statistikore të ekspertëve të sigurimit për përshtatshmërinë e rezervave teknike të një aktuari të miratuar nga BPK-ja. Aktuari për sigurimin e jetës duhet të marrë parasysh faktorët e tillë siç janë diagramet e vdekshmërisë, nivelet e kamatave të interesit dhe shpenzimet, për të përcaktuar nëse niveli i rezervave teknike është adekuat dhe nëse ekzistojnë pasuri për t'i përmbushur detyrimet e kompanisë së sigurimit të jetës.

51.2 Për kompaninë e sigurimit të përgjithshëm, BPK-ja mund të kërkojë dorëzimin e ekspertizës së sigurimeve ose dispozitën për certifikatën e ekspertit të dëmeve mbi përshtatshmërinë e dispozitave teknike në lidhje me dorëzimin e gjendjeve vjetore financiare.

51.3 Eksperti i sigurimit ose dispozita për certifikatën e ekspertit të dëmeve mund të kërkohej më shpesh nëse BPK-ja vendos po qe se pozita financiare e kompanisë së sigurimit e kërkon atë.

51.4 Ekspertiza ose dispozita për verifikimin e dëmeve nga eksperti duhet të shprehë mendimin lidhur me atë nëse dispozitat teknike të kompanisë së sigurimit janë të mjaftueshme për t'i përmbushur përgjegjësitë e tyre.

51.5 Eksperti i sigurimit duhet t'i raportojë drejtpërdrejt bordit të drejtorëve të kompanisë dhe BPK-së nëse, sipas gjykimit të ekspertit të sigurimeve, konkluzat e verifikimit të ekspertit të sigurimit janë mënjanuar, injoruar ose në mënyrë joadekuate janë ndikuar nga menaxhmenti i kompanisë së sigurimit ose bordi i drejtorëve.

KAPITULLI VIII QEVERISJA E BASHKUAR DHE KONTROLLAT E BRENDSHME

Neni 52

Parimet e qeverisjes

52.1 Shkeljet e dukshme dhe të vërteta të përgjegjësive fiduciare në favor të interesit personal apo të personave të tjerë duhet menjëherë t'i raportohen BPK-së. Kur BPK-ja kupton se një drejtor ose nëpunës ka shkelur përgjegjësitë fiduciare në favor të interesave personale apo në favor të personave të tjerë, qoftë ai i afërt apo jo me drejtorin ose nëpunësin, kjo përbën arsyë për vënien e masave ndëshkuese nga ana e BPK-së dhe, sipas nevojës, inicimin e procedurës së mundshme penale.

52. 2 Kur bordi i drejtorëve të një kompanie të sigurimit ose të një ndërmjetësi të sigurimit refuzon të shkarkojë drejtorin ose nëpunësin në pajtim me urdhërin e BPK-së kur ka pasur shkelje të qartë të detyrave financiare, kjo kompani ose ndërmjetësuesi i sigurimit dhe drejtorët e saj i nënshtrohen masave ndëshkuese shtesë.

52. 3 Drejtorët dhe nëpunësit e kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit si dhe nëpunësit përfaqësues të degës duhet të jenë persona “të përshtatshëm dhe adekuat” për të ushtruar rolin e tyre. Atyre nuk u lejohet që marrëdhëniet e tyre me aksionarët apo ndërmjetësuesit e kompanive të sigurimit, drejtorët, nëpunësit ose punonjësit tjerë të ndikojnë në çfarëdo mënyre në detyrat e tyre fiduciare ndaj poseduesve të policave.

52. 4 Drejtorët dhe nëpunësit e lartë të kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësimit të sigurimit si dhe zyrtarët përfaqësues të degës, nuk mund t’i mbajnë dy vende të ndryshme në kompani kur mbajtja e dy vendeve mund të shkaktojë konflikt interesash.

52. 5 BPK-ja në çdo kohë mund t’iu kërkojë drejtorëve dhe nëpunësve të lartë të një kompanie apo ndërmjetësuesi të sigurimit si dhe nëpunësve përfaqësues të një dege, t’i sigurojnë BPK-së një pasqyrë zyrtare të pranueshme për BPK-në, e cila dëshmon se nuk ekzistojnë kurrfarë procedurash penale në të kaluarën apo në të tashmën ku ata ja në të përfshirë.

52. 6 BPK-ja i shqyrton biogarfitë personale formale të drejtorëve dhe nëpunësve të propozuar të një kompanie sigurimi ose të një ndërmjetësuesi të sigurimit dhe të nëpunësve përfaqësues të degës.

52. 7 BPK-ja mund ta refuzojë një drejtor ose nëpunës të lartë të mundshëm me arsyen se interesat më të larta të kompanisë së sigurimit, të ndërmjetësuesit të sigurimit dhe të tregut të sigurimit nuk do të kryhen si duhet me pranimin e kandidatit për drejtor apo nëpunës të lartë.

52. 8 BPK-ja mund të refuzojë nëpunësin e mundshëm përfaqësues të një dege me arsyen se interesat më të larta të kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit dhe të tregut të sigurimit nuk do të kryhen si duhet me pranimin e kandidatit për nëpunës përfaqësues”.

52. 9 BPK-ja mund të përcaktojë udhëzime ose procedura të mëtejme lidhur me çështjen e këtij neni me një rregull të BPK-së.

Neni 53 Bordi i drejtorëve

53. 1 Çdo kompani sigurimi ose kompani ndërmjetësuese e sigurimit e organizuar sipas ligjit të Kosovës do të administrohet nga bordi i drejtorëve i cili përbëhet nga një numër tek prej jo më pak se pesë anëtarëve. Shumica e anëtarëve të bordit të drejtorëve duhet të jenë banorë të Kosovës. Nëpunësi i lartë është i vetmi punëtor i cili mund të shërbejë në bordin e drejtorëve.

53. 2 Bordi i drejtorëve duhet të zgjedhet nga aksionarët për një afat jo më të gjatë se dy (2) vjet dhe mund të riemërohet për periudhat e ngjashme të mëvonshme. Tubimi i përgjithshëm i aksionarëve mund të caktojë një kompensim të arsyeshëm për anëtarët e bordit. BPK-ja mund t’i urdhërojë drejtorit që ta kthejë kompensinin nëse vendos se kompensimi i pranuar është i dëmshëm për interesat e poseduesve të policave të kompanisë së sigurimit.

53.3 Bordi i drejtorëve është përgjegjës për caktimin e qëndrimeve, procedurave dhe praktikave të cilave duhet përmbajtur kompania e sigurimit ose kompania e ndërmjetësimit të sigurimit dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Politika, procedurat dhe praktikave të caktuara duhet të përfshijnë politikën dhe procedurat e investimeve të regjistruara, si dhe politikën dhe procedurat e garantimit.

53.4 Drejtorët duhet të veprojnë në cilësi të ndërmjetësimit dhe detyrë parësore e tyre është mbrojtja e interesave të poseduesve të policave. Ata nuk guxojnë të lejojnë që rolet tjera të tyre të ndikojnë në marrjen e vendimeve dhe miratimin e parimeve, procedurave dhe praktikave që mund të konsiderohen të kundërta me interesat e poseduesve të policave.

53.5 Drejtorët e kompanisë së sigurimit apo të kompanisë ndërmjetësuese të sigurimit i ushtrojnë detyrat e tyre për të garantuar: se rezervat teknike janë të mjaftueshme; se minimumi i margjinës së aftësisë pagyese - kapitalit dhe i kërkesave të rezervave, siç është përcaktuar nga BPK-ja respektohet tërë kohën; se kompania e sigurimit ose kompania ndërmjetësuese e sigurimit ka likuiditet të mjaftueshëm gjatë tërë kohës; se kompania e sigurimit ose kompania ndërmjetësuese e sigurimit i respekton të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje dhe rregullat e BPK-së gjatë tërë kohës; se nëpunësit kanë përgjegjësi adekuate për zbatimin e duhur të të gjitha urdhërësive të bordit të drejtorëve; se kompania e sigurimit ose kompania ndërmjetësuese e sigurimit mban një standard të pranueshëm të kontrollit të brendshëm dhe se revizioni financiar i jashtëm dhe i brendshëm është mjaft i gjerë si për nga vëllimi dhe thellësia.

Neni 54

Menaxhimi

54.1 Nëpunësit e lartë të kompanisë së sigurimit ose kompanisë ndërmjetësuese të sigurimit janë anëtarë të bordit të drejtorëve, por nëpunësi i lartë nuk mund të punojë në të njëjtën kohë si kryesues i bordit të drejtorëve. Nëpunësi i lartë i raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt bordit të drejtorëve lidhur me zbatimin e politikës, procedurave dhe praktikave të kompanisë të miratuar nga bordi i drejtorëve.

54.2 Nëpunësi i lartë i kompanisë së sigurimit ose i ndërmjetësuesit të sigurimit duhet të jetë banor i Kosovës.

Neni 55

Kontrollat e brendshme

55.1 Kompanitë e sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të mbajnë kontrole adekuate interne. Kontrollat e brendshme përfshijnë sajimin e policave plotësisht të dokumentuara, të procedurave dhe praktikave për aktivitetet e garantimit dhe investimit.

55.2 BPK-ja mund të parashtrijë kushte plotësuese për kontrollat e brendshme përmes rregullave ose urdhërësive.

Neni 56

Konfliktet e interesave

56.1 Drejtorët, nëpunësit dhe punëtorët e kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të veprojnë në mënyrë fiduciare për t'i ruajtur interesat e poseduesve të policave të tyre.

56.2 Transaksionet mes palëve të afërta ndalohen, përveç rasteve kur parashihet ndryshe përmes rregullave të BPK-së.

56.3 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit nuk mund të hyjnë në transaksion me një person apo në të mirë të një personi të afërt me kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësuesin e sigurimit në kushte më favorizuese se ato që janë në dispozicion për personat e tjerë, të cilët nuk janë në lidhje me kompaninë e sigurimit ose me ndërmjetësuesin e sigurimit.

KAPITULLI IX PRAKTIKA E TREGUT DHE MBROJTJA E KLIENTIT

Neni 57

Sjellja në treg dhe mbrojtja e klientit

57.1 Kompanitë e sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit u ofrojnë këshilla poseduesëve të mundshëm të policave të sigurimit në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe të saktë. Ata gjithmonë duhet të veprojnë me ndershmëri të lartë.

57.2 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit nuk duhet të ofrojnë informata apo të bëjnë prezentime që kanë gjasë t'i çorientojnë ose mashtrjnë poseduesit e mundshëm të policave të sigurimit.

57.3 Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit duhet të sigurojë informacion të mjaftueshëm për poseduesit potencialë të policave të sigurimit lidhur me vlerësimin e nevojave të tyre. Ata duhet të vlerësojnë profesionalisht kushtet e poseduesve potencialë të policave dhe të ofrojnë ndihmë në përgjigjen ndaj nevojave të atij personi.

57.4 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit i informojnë në mënyrë të plotë poseduesit e mundshëm të policave të sigurimit lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre para se ata të pranojnë një policë sigurimi. Megjithatë, poseduesit e policave duhet të marrin përgjegjësinë përfundimtare lidhur me rreziqet me të cilat ndeshen dhe për blerjen e policës së të përshtatshme të sigurimit për ato nevoja.

57.5 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet t'i respektojnë të gjitha ankesat legjitime. Ata gjithmonë duhet të veprojnë me kujdesin dhe konsideratën e duhur për poseduesit e tyre të policave. Ata duhet të ofrojnë shërbim kompetent dhe profesional.

57.6 Kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit duhet të zbatojnë një sistem të brendshëm formal për të trajtuar ankesat lidhur me dëmet për të cilat ankohen poseduesit e policave. Ankesat duhet të trajtohen drejt dhe në mënyrë efikase. Kompanitë e sigurimit duhet të themelojnë një forum arbitrazhi, të pavarur nga kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e tyre, për t'i shqyrtuar rastet kur mekanizmat e brendshëm të kompanisë ose ndërmjetësuesit nuk i kanë zgjedhur në mënyrë të kënaqshme ankesat e poseduesve të policave. Forumi i arbitrazhit duhet t'i raportojë BPK-së për rezultatet e shqyrtimeve të tij në baza tremujore.

57.7 Në rast se BPK-ja mendon se nuk ka anagzhim të duhur për themelimin e një forumi të tillë të pavarur, BPK-ja mund të nxjerrë një rregull ose urdhëresë për të detyruar formimin e tij me kohë.

Neni 58
Formularët e policave

58.1 Formularët e policave të sigurimit për çdo klasë të sigurimit të shkruara nga një kompani sigurimit duhet t'i dorëzohen BPK-së për miratim para përdorimit të tyre. BPK-ja i shqyrton kushtet e përgjithshme dhe rrethanat e policave lidhur me arsyeshmërinë e tyre. Çfarëdo ndryshimesh materiale të këtyre kushteve dhe rrethanave duhet të miratohen nga BPK-ja.

58.2 BPK-ja ka autorizimin për të kërkuar, shqyrtuar dhe miratuar informacionin e përgatitur në lidhje me prodhimet dhe shërbimet e kompanisë së sigurimit.

Neni 59
Policat e sigurimit

59.1 Polica e sigurimit bëhet në formë të shkruar në letër, me shënimet e ruajtuara në letër dhe në formë elektronike. Si poseduesi i policave ashtu edhe kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit që punon për kompaninë e sigurimit nënshkruajnë një kopje të dokumentit në letër.

59.2 Kompania e sigurimit, ndërmjetësuesi i sigurimit dhe poseduesi i policës, potencial apo ekzistues, secili duhet të veprojë në nivelin më të lartë të mirëbesimit gjatë tërë kohës. Të gjitha palët duhet të hyjnë në marrëveshje sigurimi në baza të drejta e vullnetare pa asnjë shtrëngim nga ana e palës tjetër.

59.3 Polica e sigurimit duhet të ketë elementet vijuese për të pasur forcë ligjore në Kosovë. Ajo duhet:

- (a) Të mbulojë interesin e siguruar të poseduesit të policës apo të një shfrytëzuesi të caktuar;
- (b) Të sigurojë shumën e siguruar;
- (c) Të ketë datën e nënshkrimit;
- (ç) T'i përkufizojë qartë rreziqet e mbuluara;
- (d) T'i parashtrijë saktësisht dhe qartë rreziqet e përjashtuara;
- (dh) T'i përcaktojë primet e sigurimit që duhet paguar dhe datat e duhura për pagesë;
- (e) Të përcaktojë datën e fillimit dhe të përfundimit të kontratës;
- (ë) Të përmbajë një gjendje të qartë dhe të plotë të të gjitha kushteve dhe rrethanave të policës së sigurimit;

(f) T'i parashtrijë të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse të poseduesit të policës, të kompanisë së sigurimit dhe ndërmjetësuesit të sigurimit nëse është e zbatueshme;

(g) T'i ofrojë poseduesit të policës të ketë mundësinë të anulojë policën e sigurimit brenda dhjetë (10) ditësh nga nënshkrimi i kontratës dhe të marrë kompenzimin e plotë për primet e paguara, me kusht që t'i zbritet pagesa administrative që mund të mos tejkalojë dhjetë (10) për qind të shumës së primit të paguar;

(gj) Të përmbajë dispozitën që respekton përcaktimin e forumit të pavarur të arbitrazhit për caktimin e dëmeve të kontestuara me kompetencën për të zbatuar vendimin, të përcaktuar në pajtim me nenin 58 të kësaj rregulloreje;

(h) Të shpallë emrin e ligjshëm dhe adresën e kompanisë së sigurimit;

(i) Të shpallë emrin e ligjshëm dhe adresën e poseduesit të policës së sigurimit dhe të shfrytëzuesit kur ky i fundit është i ndryshëm prej të parit.

Neni 60

Ndryshimi i policës së sigurimit

Polica e sigurimit mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe vetëm nëse nënshkruhet nga të dyja palët.

Neni 61

Skadimi i policës së sigurimit

61.1 Polica e sigurimit skadon në rastet vijuese kur:

(a) Përfundon kontrata;

(b) Përfundon periudha e sigurimit të saktësuar në policë;

(c) Poseduesi i policës anulon ose tërheq policën në pajtim me kushtet e parashtruara me këtë rregullore;

(ç) Palët kontraktuese bashkarisht vendosin të përfundojnë policën e sigurimit para datës së caktuar në kontratë;

(d) Kompania e sigurimit ka përmbushur detyrimet kontraktuese.

61.2 Të gjitha policat e pazgjdhura të sigurimit të lëshuara nga një kompani e sigurimit skadojnë tridhjetë ditë pas publikimit të vendimit të BPK-së për të anuluar licencën e kompanisë së sigurimit.

Neni 62

Të drejtat e veçanta dhe detyrimet e poseduesve të policave

62.1 Pavarësisht nga kushtet e policës së sigurimit, poseduesi i policës mundet:

(a) Nëse një ngjarje e siguruar ende nuk ka ndodhur ta anulojë policën e sigurimit përmes dërgimit të njoftimit me shkrim kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit brenda dhjetë (10) ditë pune pasi poseduesi i policës të ketë nënshkruar policën e sigurimit dhe poseduesi i policës do të ketë të drejtë për kompenzimin të menjëhershëm të shumës së paguar për policën e sigurimit dhe

(b) Të kërkojë arbitrimin mandator para një gjykate adekuate për çfarëdo kontesti lidhur me dëmin kundrejt kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit lidhur me policën e sigurimit.

62.2 Pavarësisht nga kushtet e policës së sigurimit, poseduesi i policës së sigurimit duhet të:

(a) Bëjë zbulimin e plotë dhe të vërtetë të fakteve që mund të ndikojnë në vendimin e kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit në emër të kompanisë së sigurimit për të garantuar rrezikun;

(b) Paguajë shumat e primit kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit në kohën e duhur, siç parashtrohet në policën e sigurimit;

(c) Të ndërmarrë hapa të arsyeshëm me qëllim të zvogëlimit të humbjeve që rrjedhin nga një ngjarje e siguruar sapo poseduesi i policës të ketë kuptuar se ka ndodhur ngjarja;

(ç) Ta njoftojë kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësuesin e sigurimit se një ngjarje e siguruar ka ndodhur sa më shpejtë që praktikisht të jetë e mundur dhe pas njoftimit se ngjarja ka ndodhur, përveç nëse parashihet ndryshe në policën e sigurimit,

(d) T'i ofrojë kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit çfarëdo dëshmie të arsyeshme që kërkohet, për t'i mundësuar kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit që të vlerësohet shkaku dhe natyra e dëmit dhe

(dh) Të këshillojë kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësuesin e sigurimit mbi rrethanat e ndryshuara pas lëshimit të policës së sigurimit, që përndryshe do të mund t'i rrisnin gjasat për paraqitjen e kërkesës për të paguar dëmin.

62.3 Në rast se poseduesi i policës e anulon policën e sigurimit brenda afatit prej dhjetë ditësh siç parasheh ky nen, kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit mund të ndalë kompenzimin e pagesës administrative deri në dhjetë për qind (10%) të primeve të përgjithshme që do të duhej të paguheshin sipas policës së sigurimit.

Neni 63

Të drejtat e veçanta dhe detyrimet e kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit

63.1 Kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit:

(a) Pasi t'i ofrojë me shkrim poseduesit të policës një afat prej tridhjetë ditësh dhe t'i jepë mundësi për ankesë, mund ta përfundojë policën e sigurimit nëse poseduesi i policës nuk e paguan primin në afatin e duhur;

(b) Pas ofrimit me shkrim të një afati prej dhjetë ditësh mund ta përfundojë policën e sigurimit kur poseduesi i policës e ka vonuar më shumë se tridhjetë ditë pagesën e primit në më shumë se një rast gjatë afatit të policës së sigurimit;

(c) Mund ta përfundojë menjëherë policën e sigurimit nëse poseduesi i policës me qëllim ka fshehur ose falsifikuar të dhënat e kërkuara për lëshimin e policës;

(ç) Të mbajë primet dhe të refuzojë pagesën e dëmit në rastet kur poseduesi i policës me qëllim ka fshehur ose falsifikuar informacionin e kërkuar për lëshimin e policës dhe

(d) Të kërkojë dëmet financiare nga poseduesi i policës i cili ka falsifikuar kërkesën për dëmin e bërë.

63.2 Megjithë kushtet e policës së sigurimit, kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit duhet:

(a) T'i përgatisë policat e sigurimit me shkrim dhe të sigurojë një kopje të kontratës për poseduesin potencial të policës së sigurimit për shikim dhe nënshkrim;

(b) T'i përfshijë të gjitha kushtet dhe rrethanat me një gjuhë të qartë, të lehtë e të kuptueshme;

(c) T'i zbulojë të gjitha të dhënat relevante për policën dhe pagesën e saj, që janë të mjaftueshme për t'i mundësuar poseduesit të policës të bëjë një vendim të informuar lidhur me pagesën e policës së sigurimit para nënshkrimit të kontratës;

(ç) Të pranojë dëftesat dhe të hulumtojë e paguajë shpejt dëmet e ligjshme të sigurimit;

(d) Të njoftojë shpejt me shkrim poseduesin e policës nëse kompania e sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit konsideron se informacioni i siguruar nga poseduesi i policës është jo i plotë ose joadekuatë dhe t'i ofrojë poseduesit të policës deklaratën se çfarë informacioni plotësues nevojitet;

(dh) T'i kompenzojë shpenzimet e arsyeshme të shkaktuara nga poseduesi i policës kur poseduesi i policës ka ndërmarrë hapa për të minimizuar humbjen ose dëmin e pësuar pas ndodhjes së një ngjarjeje të siguruar dhe

(e) Të ofrojë mekanizëm për poseduesit e policave për t'iu paraqitur kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit për kompenzim në rast të pakënaqësisë rreth zgjidhjes së dëmit.

Neni 64 Konfidencialiteti

Aksionarët e tashëm dhe të kaluar apo pronarët, drejtorët dhe agentët e një kompanie sigurimi dhe ndërmjetësuesi i sigurimit duhet të mbajnë sekretin dhe nuk duhet të përdorin për përfitimin e tyre personal apo t'ua lejojnë personave të tjerë zbulimin e çfarëdo informacioni jopublik që i marrin gjatë punës së kompanisë. Përkundër këtij kufizimi, informacioni i tillë mund t'i zbulohet BPK-së, duke përfshirë edhe kontrolluesit dhe autoritetet e saj, mandej

informacioni mund t'u zbulohet autoriteteve gjyqësore në rastet kur parashihet me ligj, autoriteteve të tjera mbikëqyrëse në Kosovë siç parashihet me ligj, mbikëqyrësve të institucioneve financiare ndërkombëtare si dhe atëherë kur mbrojtja e interesit ligjor të vetë kompanisë e kërkon zbulimin në procedurat ligjore.

Neni 65

Shitja e sigurimit përmes internetit

Kompanitë e sigurimit ose ndërmjetësuesit e sigurimit mund të mos u ofrojnë produktet e sigurimit përmes internetit personave jashtë Kosovës pa lejen paraprake me shkrim të BPK-së. Leja e tillë mund të jepet vetëm pas dorëzimit të një plani të punës që përvijon mënyrën e punës së kompanisë apo ndërmjetësuesit për t'u siguruar se poseduesit e policave jashtë Kosovës janë të mbrojtur si edhe ata në Kosovë. BPK-ja mund të ofrojë kushte dhe udhëzime me rregulla të BPK-së për shitjen e sigurimeve përmes internetit.

KAPITULLI X ADMINISTRIMI LIGJOR

Neni 66

Inicimi i administrimit ligjor

66.1 Pas anulimit të licencës, BPK-ja emëron menjëherë një administrues të përkohshëm për të marrë në pronësi dhe kontroll kompaninë e sigurimit dhe ndërmjetësin e sigurimit. Procedura njihet si administrim ligjor.

66.2 Pavarësisht nga çfarëdo ligji të falimentimit në fuqi në Kosovë, dispozitat e këtij kapitulli mbi administrimin ligjor do ta kontrollojnë procesin e administrimit dhe likuidimit të kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit.

Neni 67

Likuidimi vullnetar

Nëse aksionarët ose pronarët e kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesi i sigurimit dëshirojnë që vullnetarisht ta likuidojnë kompaninë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/16 të datës 8 shkurt 2001 mbi Shoqëritë Tregtare apo çfarëdo ligji tjetër në fuqi, ata duhet t'i paraqesin BPK-së një kërkesë për miratimin e likuidimit vullnetar, shoqëruar me të dhëna të tilla që BPK-ja mund t'i përcaktojë. BPK-ja duhet të bëjë hetime të duhura për punët e kompanisë dhe, nëse bindet vetë se interesat e poseduesve të policave dhe të kreditorëve të saj do të mbrohen në mënyrë të mjaftueshme, atëherë mund të miratojë likuidimin vullnetar sipas ligjit në fuqi ose të vendosë se për zbatimin e kësaj Rregulloreje si dhe të caktojë administratorin ligjor në pajtim me këtë kapitull.

Neni 68

Konsideratat e veçanta për kompanitë insolvente të sigurimit të jetës

68.1 Nëse BPK-ja vendos se një kompani e sigurimit të jetës ka gjasë të falimentojë, në bazë të mendimit të dëshmuar të ekspertëve dhe të një mendimi të pavarur statistikor ose përmes mënyrave të tjera, mund t'i transferojë policat e kompanisë së sigurimit të jetës,

kapitalin, detyrimet financiare së bashku me dispozitat teknike në kompanitë e tjera të sigurimit të jetës në tregun e sigurimeve në Kosovë në mbështetje të pajtimit reciprok.

68. 2 Nëse BPK-ja nuk është në gjendje të bëjë transferin sipas nenit të mësipërm, atëherë ajo mund t'i transferojë policat e kompanisë së sigurimit të jetës, kapitalin, detyrimet financiare, duke përfshirë edhe dispozitat teknike, në kompanitë e tjera të sigurimit të jetës të licencuara jashtë Kosovës. Në rast se një transfer i tillë nuk është i mundur, BPK-ja mund t'i urdhërojë kompanive ekzistuese të sigurimit të jetës në Kosovë për t'i marrë policat e sigurimit të jetës, kapitalin, detyrimet financiare, duke përfshirë edhe dispozitat teknike në bazë të një përqindjeje dhe në madhësi të dispozitave të tyre teknike, siç është paraqitur në raportet financiare të tyre të fundit. BPK-ja do të bëjë përpjekje për të realizuar këtë veprim në mënyrë sa më të drejtë që të jetë e mundur dhe pa u shkaktuar dëme të panevojshëm financiare kompanive të sigurimit të jetës që mbijetojnë.

Neni 69

Administratori i përkohshëm

69. 1 Administrator ligjor mund të jetë personi nga sektori privat apo një zyrtar i BPK-së, i cili i plotëson kushtet e parashtruara nga BPK-ja. BPK-ja mundet për ndonjë arsye ta largojë administratorin ligjor. Në kushtet e pagesës së administratorit ligjor (ekzekutuesi i falimentimit) mund të përfshihet nxitja për likuidimin e shpejtë të pasurisë dhe shpërndarja e përfitimeve poseduesve të policave dhe kreditorëve si dhe mund të përfshihen ndëshkimet për mosrealizimin e objektivave të tilla.

69. 2 Pagesa e administratorit ligjor dhe e ekspertëve të angazhuar nga administratori ligjor, kompenzimi i shpenzimeve të tyre si dhe shpenzimet e BPK-së për zbatimin e kësaj Rregulloreje përkritazi me kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësuesin e sigurimit duhet të bëhen nga fondet e kompanisë. Pagesat për administratorin ligjor bëhen në mënyrë të vazhdueshme. Çfarëdo detyrimi ndaj administrimit të përkohshëm duhet të paguhet nga fitimi i shitjeve të pasurisë së kompanisë në nivelin e përparësisë të parashtruar në këtë kapitull mbi administrimin e ligjor.

Neni 70

Njoftimi dhe regjistrimi i administratës ligjore

70. 1 Administratori ligjor brenda dy ditësh pas caktimit dërgon me postë njoftimin në çdo zyrë të kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit me të cilin shpallet caktimi në pajtim me këtë Rregullore, i cili saktëson datën e hyrjes në fuqi dhe kohën e marrjes në zotërim nga administratori ligjor në bazë të të cilit saktësohet se:

(a) autorizimet e personave për t'u angazhuar lidhur me përgjegjësinë financiare të kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit kanë qenë anuluar;

(b) personat të cilët më parë kanë pasur autorizime për të dhënë udhëzime në emër të kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit lidhur me pagesat apo transferin e pasurisë së kompanisë apo pasuri e administruar nga kompania nuk kanë më ato autorizime;

(c) licenca e kompanisë së sigurimit ose e ndërmjetësuesit të sigurimit është anuluar dhe

(ç) dëshmia e dëmeve kundër kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit duhet t'i dorëzohet administratorit ligjor brenda nëntëdhjetë ditësh pas anulimit të licencës.

70.2 Administratori ligjor duhet të publikojë njoftimin me të cilin saktësohen veprimet e ndërmarra sipas këtij neni në një ose në më shumë gazeta me qarkullim të gjerë në Kosovë. Publikimi duhet të bëhet jo më rrallë se një herë në javë brenda katër javësh. BPK-ja do të shikojë dhe miratojë përmbajtjen e njoftimit.

Neni 71

Autorizimet dhe detyrat e administratorit ligjor dhe efektet e administrimit ligjor

71.1 Funksionet kryesore të administratorit ligjor janë që të administrojë kompaninë e sigurimit ose ndërmjetësuesin e sigurimit në likuidim, ta likuideojë pasurinë e tyre, të paguajë dëmet që u janë shkaktuar poseduesve të policave dhe kreditorëve. Administratori ligjor i ka të gjitha autorizimet e drejtorëve dhe aksionarëve të kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesve të sigurimit në fjalë. Në varësi të qëllimit primar për plotësimin maksimal të detyrimeve të kompanisë ndaj poseduesve të policave dhe kreditorëve, administratori ligjor e shpejton shitjen e pasurisë së kompanisë dhe pasurinë e poseduesve të policave e të kreditorëve.

71.2 Administratori ligjor mund të vazhdojë me çfarëdo veprimi në drejtim të likuidimit të kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit. Administratori ligjor nuk mund të lëshojë qëndrime të reja apo të zgjerojë afatin e politikës ekzistuese. Administratori ligjor, pas marrjes së miratimit me shkrim të BPK-së, mund të huazojë para në baza të siguruara apo të pasiguruara. Administratori mund të ndalojë ose kufizojë pagimin e çfarëdo detyrimi nga punonjësit ose të largojë nga puna çdo zyrtar, nëpunës apo këshilltar, të ekzekutojë çfarëdo instrumenti në emër të kompanisë apo të iniciojë ose të mbrojë e të ndërmarrë në emër të kompanisë së sigurimit a ndërmjetësuesit të sigurimit çfarëdo veprimi apo procedure ligjore.

71.3 Administratori ligjor ka autorizime të pakufizuara për të hyrë dhe për t'i kontrolluar zyret, librat e llogarive dhe shënimet tjera si dhe pasurinë dhe detyrimet tjera të kompanisë së sigurimit a ndërmjetësuesit të sigurimit dhe filialave të tyre. Me kërkesën e administratorit ligjor, zyrtari i zbatimit të ligjit ose zyrtarët i ndihmojnë administratorit ligjor që të hyjë në objektet e kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit për t'i kontrolluar shënimet e saj.

71.4 Administratori ligjor ka të drejtë të paraqesë padi dhe të mbrohet kundër padive në gjyq dhe proceseve gjyqësore arbitrare në emër të kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit në falimentim.

71.5 Administratori ligjor ka të drejta dhe privilegje të njëjta dhe i nënshtrohet detyrimeve, ndëshkimeve, kushteve dhe kufizimeve të njëjta që zbatohen për administruesit apo të punësuarëve të tjerë të një kompanie të sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit të licencuar me këtë Rregullore.

71.6 Të drejtat e administratorëve dhe të aksionarëve të kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit suspendohen gjatë administrimit ligjor. Administratori ligjor i mban disa apo të gjithë administratorët me kompenzim të arsyeshëm që nevojitet për të administruar falimentimin dhe për t'i kryer funksionet posaçërisht të caktuara me shkrim nga administratori ligjor. Administratori i përkohshëm mund t'i largojë nga puna të gjithë

punonjësit e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit dhe ata nuk mund të marrin kompenzim nga kompania e sigurimit apo ndërmjetësuesi i sigurimit.

71.7 Administratori i përkohshëm e siguron pasurinë e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit dhe kërkon mbrojtjen e saj nga vjedhja apo nga ndonjë veprim tjetër i papranueshëm duke ndërmarrë veprime që veçmas përfshijnë:

- (a) Ndërrimin e drynave dhe kufizimin e përdorimit të çelësave të hyrjeve të jashtme të zyrave të kompanisë së sigurimit dhe të zyrave të brendshme ku ka mjete financiare, të dhëna apo pajisje që do t'i mundësonin ndonjë individ të ketë qasje joligjore në mjetet financiare;
- (b) Ndërrimin apo krijimin e kodeve të reja të kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit në kompjutorët e administrimit ligjor dhe t'i lejohet qasje vetëm një numri të caktuar të të punësuarëve të besueshëm;
- (c) Lëshimin e kartelave të reja të identifikimit me fotografi për hyrje të të punësuarëve të autorizuar në lokalet e kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit dhe kontrollit të hyrjes së personave të tjerë në këto lokale.
- (ç) Anulimin e autorizimeve për caktimin e përgjegjësive financiare të kompanisë së sigurimit ose ndërmjetësuesit të sigurimit dhe lëshuarjen e autorizimeve të reja adekuate dhe njoftimi i palës së tretë për këtë;
- (d) Informimin e pronarëve të policave, agjentëve, nënagjentëve, brokerëve, kompanive të risigurimit, zyrave relevante për tatim, bankave dhe bizneseve që udhëheqin afarizmin me kompaninë e sigurimit apo ndërmjetësuesin e sigurimit se personat të cilët më parë kanë qenë të autorizuar për të dhënë këshilla në emër të kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit lidhur me udhëheqjen e pasurisë dhe llogarive nuk kanë më autorizime të tilla dhe se vetëm administratori ligjor dhe individët e autorizuar nga ai kanë një autorizim të tillë dhe
- (dh) Pezullimin e pagesave në përgjithësi me shpërndarje të gjerë dhe të pagesave të çfarëdo lloji për administratorët dhe aksionarët me kushtë që administratorëve t'u paguhet rroga bazë për shërbimet e bëra sipas cilësisë së tyre si administratorë të kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit.

71.8 Administratori ligjor miraton një bilanc të ri përfundimtar të kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit në bazë të vendosmërisë së administratorit për likuidimin e vlerës së pasurisë së kompanisë me zvogëlimin ekvivalent në vlerën e detyrimeve të kompanisë me rendin e kundërt të prioriteteve për pagesë të distribuimeve në likuidimin e pasurisë së kompanisë. Detyrimet do të konsiderohen si të pritura dhe kamata do të pushojë së rrituri qysh nga dita e emërimit të administratorit ligjor.

71.9 Brenda një muaji pas marrjes në posedim të kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit, administratori ligjori bën regjistrimin e pasurisë dhe të pasurisë së kompanisë dhe ia përcjellë një kopje të saj BPK-së e cila do t'ia vë në dispozicion një kopje publikut për vlerësim.

71.10 Pas marrjes në posedim të kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit nga administratori ligjor:

- (a) Skadon çdo afat, pushon çdo çështje statutare, kontraktuese apo tjetërfare; kërkesat apo të drejtat e kompanisë së sigurimit a të ndërmjetësuesit të sigurimit që skadojnë apo shuhen do të zgjaten edhe për 6 muaj nga dita e skadimit apo e shuarjes;
- (b) Çdo konfiskim apo kamatë sigurie (përveç asaj që ekziston gjashtë (6) muaj para ditës së hyrjes në fuqi të administrimit ligjor) anulohet dhe asnjë konfiskim apo inters sigurie, përveç atij të krijuar nga administratorit ligjor gjatë zbatimit të këtij neni, nuk mund të konfiskohet për kurrfarë pasurie të kompanisë apo të ndërmjetësuesit të sigurimit nën administrim ligjor përderisa të zgjasë një administrim i tillë ligjor dhe
- (c) Shuhen të drejtat e aksionarëve përveç të drejtës për pranimin e pasurisë nëse diç mbetet pas kryerjes së kënaqshme të kërkesave që kanë përparësi ndaj aksionarëve dhe e drejta për të pranuar çdo pagesë neto të marrë nga të ardhurat e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit dhe kryesisht e gjithë pasuria e tij nëse administratori ligjor vërteton se kompania e sigurimit apo ndërmjetësuesi i sigurimit ka pasur vlerë neto pozitive në kohën e shitjes.

71.11 Kërkesat kundër kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit futen në dosje të administratorit ligjor brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas anulimit të licensës së kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit. Kërkesa që nuk dorëzohet brenda këtij afati kohor mund të kryhet pozitivisht vetëm pas zgjidhjes së kënaqshme të të gjitha kërkesave të klasës përkatëse, dhe vetëm atëherë kur kërkuesi ka dhënë arsytim të mjaftueshëm për kërkesën që nuk është dorëzuar në afatin e duhur. Përndryshe, kërkesa nuk do të paguhet. Procedurat e përcaktimit të vlefshmërisë, shumës së kërkesave dhe likuidimi i pasurisë së kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit dhe pagimi i kërkesave do të përcaktohet me anë të rregullave të BPK-së. Shitja e pasurisë bëhet në mënyrë transparente dhe komercialisht të arsyeshme.

71.12 Pas marrjes së miratimit paraprak të BPK-së, administratori ligjor mund të heqë dorë apo të transferojë pronën e cila i është nënshtruar të drejtës së pashmangshme të pengmarrjes si garanci pagese e poseduesit deri në kthimin e borxhit, deri sa të mbetet pak apo aspak vlerë për administrim ligjor pas përmbushjes së kënaqshme të asaj të drejte.

71.13 Administratori ligjor i raporton BPK-së për çdo muaj për mirëvajtjen e punëve të administrimit ligjor në mënyrën siç është përcaktuar nga BPK-ja.

Neni 72

Personat profesionalë

Administratori ligjor mundet qëllimisht t'i mbajë kontabilistët, aktuarët, vlerësuesit, avokatët dhe konsultantët e tjerë profesionalë vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga BPK. Kërkesa për miratim duhet të përcaktojë në hollësi nevojën për mbajtjen e tyre, kompenzimin e propozuar për personat e tillë dhe një vërtetim që dëshmon të gjitha faktet materiale se personi ka lidhje me kompaninë e sigurimit apo me ndërmjetësuesin e sigurimit. Personi nuk duhet të ketë lidhje me administratorin ligjor. Para se t'i bëhet çfarëdo pagese një personi të

tillë, administratori ligjor duhet të marrë miratimin me shkrim të BPK-së për shumën e një pagese të tillë.

Neni 73

Shmangia e transfereve para administrimit ligjor

73.1 Administratori ligjor mund të ngrisë padi në gjyq për të anuluar një transaksion të bazuar në një dokument fals apo mashtrues që kompania e sigurimit apo ndërmjetësuesi i sigurimit e ka lëshuar në dëm të poseduesve të policave a kreditorëve brenda pesë (5) viteve nga hyrja në fuqi të administrimit ligjor.

73.2 Administratori ligjor mund të ngrisë padi në gjyq për të anuluar transaksionet e mëposhtme, të cilat ndikojnë në pasurinë e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit ose për t'i kthyer nga palët e treta transferet e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit:

- (a) Transferet e kryera falas për çdo person që ka lidhje me kompaninë e sigurimit apo ndërmjetësuesin e sigurimit, që janë bërë brenda pesë (5) viteve para hyrjes në fuqi të administrimit ligjor;
- (b) Transferet e kryera falas palëve të treta brenda pesë (5) viteve para hyrjes në fuqi të administrimit ligjor;
- (c) Transaksionet në të cilat kompenzimi nga kompania e sigurimit apo nga ndërmjetësuesi i sigurimit ka tejkaluar dukshëm kompenzimin e pranuar, që është kryer brenda tri (3) viteve para hyrjes në fuqi të administrimit ligjor;
- (ç) Çdo veprim i bërë me qëllimin e të gjitha palëve të implikuara që të ndalet pasuria nga poseduesit e policave apo të kreditorëve, ose të dobësohen të drejtat e tyre brenda pesë (5) viteve para hyrjes në fuqi të administrimit ligjor;
- (d) Krijimi i së drejtës së pengmarrjes, ose ndonjë huaje në pasurinë e kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit pa miratimin paraprak të BPK-së dhe
- (dh) Transferet e pasurisë ose të parave të kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit për kreditorin apo rre të mirë të kreditorit për një borxh të shkaktuar brenda 6 muajve para hyrjes në fuqi të administrimit ligjor që ka ndikuar në rritjen e shumës të cilën kreditori do ta merrte pas likuidimit, me kusht që fuqia anuluese e këtij neni në fuqi të mos zbatohet në transferet e kryera për pronarët e policave dhe policat e tyre të sigurimit.

73.3 Administratori ligjor mund të ngrisë padi në gjyq për të anuluar transaksionet me personat lidhur me kompaninë e sigurimit apo ndërmjetësuesin e sigurimit që janë bërë brenda një vit para hyrjes në fuqi të administrimit ligjor, nëse transaksionet e tilla kanë qenë të dëmshme për interesat e pronarëve të policave të sigurimit dhe të kreditorëve të tjerë. Veprimin për anulimin e transferit mund ta bëjë administratori ligjor brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të administrimit ligjor.

73.4 Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të parashtruara në këtë nen, administratori ligjor nuk mund të anulojë një pagesë apo transfer të kompanisë së sigurimit ose të ndërmjetësuesit të sigurimit nëse është bërë në rrjedha të zakonshme të afarizmit, apo nëse kjo ka qenë pjesë e

këmbimit të njëkohshëm për një vlerë të arsyeshme ekvivalente, ose në atë masë që pas transferit marrësi i ka ofruar një kredi të pasiguar kompanisë së sigurimit a ndërmjetësuesit të sigurimit, i cila nuk ka qenë përmbushur nga kompania e sigurimit apo ndërmjetësuesi i sigurimit nga data efektive e hyrjes në fuqi të administrimit ligjor.

73.5 Administratori ligjor mund të kthejë pasurinë ose vlerën e pasurisë së transferuar nga kompania e sigurimit apo ndërmjetësuesi i sigurimit nga një përfitues i transferit fillistar vetëm nëse pranuesi i transferit fillestar nuk e ka dhënë vlerën reale të pronës dhe ka ditur se transferi fillestar ka mund të anulohet sipas kësaj rregulloreje në fuqi.

73.6 Qiradhënësi i zyrave të kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit a kryesit e shërbimeve publike, siç është për shembull rryma, gasi natyral, uji, shërbimi telefonik nuk mund t'ia ndërpresin shërbimet e tilla kompanisë vetëm për shkak të administrimit të saj ligjor apo për shkak se kompania nuk i ka paguar ato shërbime para administrimit ligjor. Pavarësisht nga ky kufizim, një qiradhënës i tillë apo kryes i shërbimeve publike mund të kërkojë që marrësi të deponojë një depozit sigurie në ndonjë bankë si kusht për qiradhënësin apo detyrat e kompanisë së shërbimeve publike për të vazhduar kryerjen e shërbimeve publike gjatë administrimit ligjor. Shuma maksimale e një depoziti të tillë nuk mund të jetë më e madhe se çmimi i shërbimeve të kryera për kompaninë e sigurimit ose për ndërmjetësuesin e sigurimit gjatë muajit menjëherë para fillimit të administrimit ligjor.

Neni 74

Përparësitë në pagesën e kërkesave

74.1 Në çdo likuidim të pasurisë së kompanisë së sigurimit apo të ndërmjetësuesit të sigurimit, kërkesat e lejuara dhe të siguruara paguhen nga fitimi i dorzanive a i pasurisë garantuese ose përndryshe dorzania i dërgohet kreditorit të siguruar. Çfarëdo shume e një kërkesë të lejuar e të siguruar që mbetet pasi pengu të jetë shpenzuar trajtohet si kërkesë e siguruar.

74.2 Kërkesat tjera të lejuara paguhen për të gjitha borxhet tjera sipas përparësive të përshkruara më poshtë:

- (a) Shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të shkaktuara nga marrësi dhe BPK-ja, duke përfshirë pagesat profesionale gjatë zbatimit të dispozitave të neneve të administrimit ligjor;
- (b) Pagat e arsyeshme dhe ndihmat e sigurimit social për punonjësit të cilat janë shkaktuar deri në dy (2) muaj para fillimit të administrimit ligjor;
- (c) Këkesat e ligjshme të papaguara të policave të sigurimit;
- (ç) Primet e pafituara;
- (d) Taksat dhe detyrimet që arrijnë brenda një (1) viti para fillimit të administrimit ligjor dhe
- (dh) Kreditorët tjerë e shumat e pasiguruara të kërkesave të siguruara.

74.3 Përmbushja e kërkesave që i takojnë një klase të mëvonshme me prioritet më të ulëta mund të inicohet vetëm pas përmbushjes complete dhe të plotë të kërkesave të klasës paraprake me prioritet më të larta. Nëse shumica në dispozicion për pagesë për çfarëdo klase të kërkesave është e pamjaftueshme për të bërë pagesën e plotë, kërkesat e tilla zvogëlohen në përmasa të barabarta.

74.4 Çfarëdo përfitimesh që mbesin pas pagimit të kërkesave të poseduesve të policave të sigurimit dhe kreditorëve të tjerë ndahen mes aksionarëve ose pronarëve të kompanisë së sigurimeve ose ndërmjetësuesit të sigurimeve në përputhje me të drejtat e tyre.

Neni 75

Dispozitat tjera të administrimit ligjor

75.1 Punonjësve dhe personave profesionalë të emëruar për të përfaqësuar ose ndihmuar administratorin ligjor ose BPK-në lidhur me administrimin ligjor nuk mund t'u paguhen shumica më të mëdha se ato që u paguhen punonjësve ose agjentëve të kompanive të sigurimeve ose ndërmjetësuesve të sigurimeve për shërbimet e ngjashme në Kosovë, përveç nëse BPK-ja mund të lejojë pagesa më të larta, nëse ajo vendos se pagimi i përqindjeve më të larta nevojitet për rekrutimin dhe mbajtjen e kuadrit të nevojshëm.

75.2 BPK-ja ka autorizime që t'i kompenzojë administratorët ligjorë dhe agjentët e tyre për punët e tyre në kushtet të cilat BPK-ja i konsideron të përshtatshme.

Neni 76

Raportimi përfundimtar BPK-së

Pasi të jetë ndarë fitimi i parave nga shitja e pasurisë së kompanisë së sigurimeve ose e ndërmjetësuesit të sigurimeve, administratori ligjor i paraqet një raport BPK-së i cili përfshin një pasqyrë të të ardhurave, të shpenzimeve, burimeve dhe shfrytëzimit të fondeve gjatë kohës së administrimit ligjor. Pas miratimit të raportit nga BPK-ja, BPK-ja dhe administratori lirohen nga çfarëdo përgjegjësie tjetër në lidhje me administrimin ligjor të kompanisë së sigurimeve ose të ndërmjetësuesit të sigurimeve.

KAPITULLI XI ZBATIMI

Neni 77

Shkeljet, gjobitjet dhe masat e mjeteve juridike

BPK-ja mund të ndërmarrë një apo më shumë prej masave vijuese lidhur me një kompani të sigurimeve ose të ndërmjetësuesve të sigurimeve nëse BPK-ja sipas gjykimit të saj vëreton se kompania ose cilido nga administratorët e saj a poseduesit e një interesi të rëndësishëm kanë shkelur ndonjë dispozitë të kësaj Rregulloreje apo instrumentet plotësuese të nxjerra në përputhje me të ose një rregullë a urdhër të BPK-së, kanë shkelur një kusht apo kufizim të ndonjë autorizimi të nxjerrë nga BPK-ja, ose janë angazhuar në ndonjë biznes a punë të pasigurtë apo aktivite të sigurimeve ajo:

- (a) Jep vërejtje me shkrim;

- (b) Kërkon prej kompanisë së sigurimeve ose ndërmjetësuesit të sigurimeve që të rrisin frekuencën e raportimit financiar;
- (c) Ndalon përtëritjen e policave ekzistuese të sigurimit apo lëshimin e policave të reja të sigurimit nga kompanitë e sigurimeve a ndërmjetësuesit e sigurimeve;
- (ç) Cakton limite dhe vë kufizime në aktivitetet e një kompanie të sigurimeve ose të një ndërmjetësuesi të sigurimeve;
- (d) Lëshon urdhër për mbylljen dhe ndërprerjen e një kompanie të sigurimit ose ndërmjetësuesi të sigurimeve;
- (dh) Cakton dënime civile në përputhje me nenin 79 të kësaj Rregulloreje;
- (e) Urdhëron kompaninë e sigurimeve ose ndërmjetësuesin e sigurimeve të marrë masa shtesë në mënyrë që t'i ruajë pasuritë e tyre;
- (ë) Kërkon nga kompania e sigurimeve ose ndërmjetësuesit e sigurimeve që të rrisin kapitalin themelues;
- (f) Kërkon prej kompanisë së sigurimeve ose ndërmjetësuesit të sigurimeve të paraqesin planin e sanimit;
- (g) Emëron një këshilltar për kompaninë e sigurimeve ose për ndërmjetësuesin e sigurimeve;
- (gj) Kërkon që një firmë revizioni e kompanisë së sigurimeve ose e ndërmjetësuesit të sigurimeve t'i raportojë drejtpërdrejt BPK-së;
- (h) Cakton një firmë të jashtme revizionimi në shpenzime të kompanisë së sigurimeve ose të ndërmjetësuesit të sigurimeve dhe kjo firmë revizionimi i raporton drejtpërdrejt BPK-së;
- (i) Emëron një ekspert sigurimesh në shpenzime të kompanisë së sigurimeve ose të ndërmjetësuesit të sigurimeve dhe ky ekspert i sigurimeve i raporton drejtpërdrejt BPK-së;
- (j) Emëron administratorin ligjor në vend të udhëheqjes aktuale të kompanisë së sigurimeve ose të ndërmjetësuesit të sigurimeve;
- (k) Vendos administrim ligjor të posaçëm për të mëkëmbur kompaninë e sigurimeve ose ndërmjetësuesin e sigurimeve;
- (l) Konfiskon dhe merr kontrollin mbi pasurinë e kompanisë së sigurimeve ose të ndërmjetësuesit të sigurimeve;
- (ll) Pezullon licencën e kompanisë së sigurimeve ose të ndërmjetësuesit të sigurimeve dhe
- (m) Anulon licencën e kompanisë së sigurimeve ose të ndërmjetësuesit të sigurimeve.

Neni 78
Dënimet jopenale

78.1 Nëse BPK-ja konstaton se ndonjë kompani e sigurimeve ose ndërmjetësues i sigurimeve, ose çdo drejtor, zyrtar a punonjës i ndonjë kompanie të sigurimeve ose ndërmjetësuesi të sigurimeve, ose ndonjë administratr i përkohshëm i emëruar sipas kësaj rregulloreje ka shkelur këtë rregullore apo cilëndo rregull a urdhër të lëshuar nga BPK-ja sipas kësaj Rregulloreje, BPK-ja cakton një dënim jopenal ndaj atij personi.

78.2 BPK-ja mund të caktojë një dënim jopenal ndaj një personi i cili trazon, vështirëson, vonon, pengon, frikëson ose ushtron ndikim të tepruar mbi stafin e BPK-së, ose që tenton të bëjë ndonjëherë prej këtyre gjërave.

78.3 BPK-ja mund të caktojë dënim jopenal ndaj çdo personi i cili me qëllim pengon administratorin ligjor që të marrë nën kontroll zyret, librat e kontabilitetit dhe të dhënat tjera si dhe pasurinë tjetër të kompanisë së sigurimeve apo të ndërmjetësuesit të sigurimeve nën administrim ligjor për të cilën administratori edhe është emëruar.

78.4 Ndëshkimi jopenal i caktuar në përputhje me këtë nen nuk duhet të pengojë zbatimin e mjeteve të tjera juridike apo ndëshkimet penale siç janë paraparë me ligjin në fuqi.

78.5 BPK-ja mund të nxjerrë rregulla që përcaktojnë shkeljet dhe dënimet jopenale për këto shkelje. Ndëshkimet e tilla mund të lëvizin prej 500 DM deri në 50.000 DM për shkeljet e personave individualë dhe prej 5.000 DM deri në 1 për qind të primeve vjetore neto të kompanisë së sigurimeve të regjistruara për shkeljet e kompanive të sigurimeve. Për shkeljet e ndërmjetësuesve të sigurimeve, dënimet mund të lëvizin prej 5.000 DM deri në 1 për qind (1%) të fitimeve neto vjetore. Nëse ekziston shkelje e vazhdueshme, secila ditë e shkeljes konsiderohet shkelje e veçantë për të cilat caktohen ndëshkime të veçanta.

78.6 BPK-ja i dorëzon menjëherë një njoftim me shkrim personit ndaj të cilit është caktuar ndëshkimi jopenal për dënimin jopenal dhe vendimet faktike që plotësojnë dënimin jopenal.

78.7 Personi ndaj të cilit është caktuar ndëshkimi jopenal sipas kësaj Rregulloreje ka të drejtë që në përputhje me nenin 81 të kësaj Rregulloreje ta kundërshtojë dënimin jopenal brenda tridhjetë ditësh nga pranimi i njoftimit me shkrim, pas së cilës datë dënimi jopenal menjëherë duhet të paguhet.

78.8 Në procedurat gjyqësore të BPK-së për të zbatimuar dënimet jopenale, njoftimi që i kumtohet personit ndaj të cilit është caktuar ndëshkimi tregon obligimin e tij për ta paguar dënimin.

78.9 Çfarëdo ndëshkimi jopenal i caktuar sipas këtij neni paguhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 79
Pezullimi dhe largimi i personave të afërt me kompaninë e sigurimeve ose me ndërmjetësuesin e sigurimeve

79.1 Nëse BPK-ja konstaton se ndonjë administrator, punonjës apo person që ka interes të rëndësishëm në një kompani të sigurimeve ose në një ndërmjetësues të sigurimeve:

(a) Ka bërë qëllimisht apo në mënyrë të vazhdueshme shkelje të kësaj Rregulloreje ose të ndonjë rregulle a urdhëri që i ka shkaktuar humbje materiale kompanisë së sigurimeve ose përfitime financiare një personi të tillë;

(b) Është angazhuara në një praktikë të pasigurt dhe jo të drejtë dhe ka vazhduar me shkeljet ose praktikën e tillë edhe pas vërejtjes me shkrim të BPK-së;

BPK-ja mund të lëshojë një urdhër që përmban njërën apo të gjitha dispozitat vijuese: (???)

(c) Kërkon shkarkimin e personit nga posti i tij apo i saj në kompaninë e sigurimeve ose në ndërmjetësuesin e sigurimeve;

(ç) Ia ndalon këtij personi shërbimin apo pjesmarrjen në punët e sigurimeve për një afat të caktuar apo përgjithmonë;

(d) Ia ndalon personit ushtrimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të të drejtës së votimit që lidhet me kompaninë e sigurimeve apo kompaninë e ndërmjetësuesit të sigurimeve;

(dh) Kërkon prej personit që të heqë dorë nga tërë pjesa apo një pjesë e interesit pronësor të tij apo të saj të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në kompaninë e sigurimeve ose në ndërmjetësuesin e sigurimeve apo të ndërprejë mbajtjen e një interesi të rëndësishëm në të dhe

(e) Kërkon prej personit që t'ia kompenzojë kompanisë së sigurimeve ose ndërmjetësuesit të sigurimeve dëmet e shkaktuara nga këto shkelje.

79.2 Nëse ndonjëri prej këtyre personave është i akuzuar me ndonjë akuzë penale, BPK-ja lëshon urdhërin për suspendimin e përkohshëm të këtij personi nga posti i tij a i saj në kompaninë e sigurimeve ose në ndërmjetësuesin e sigurimeve dhe, nëse është e zbatueshme, suspendimin e ushtrimit të së drejtës së votimit për aksionet e kompanisë së sigurimeve nga ky person deri në zgjidhjen e lëndës penale. Pezullimi i lëndës penale apo vendimi objektiv për pafajësi nuk e pengon BPK-në që të marrë ndonjë masë ligjore sa i përket personit të autorizuar sipas kësaj Rregulloreje.

79.3 Asnjë person nuk mund të mbajë një post, ose të marrë pjesë në çfarëdo mënyre në kryerjen e aktivitetit të cilitdo anëtar të një kompanie të sigurimeve pa miratimin paraprak me shkrim nga BPK-ja, nëse ai person i nënshtrohet ndonjë urdhëri të BPK-së për suspendimin apo largimin e tij nga një post në kompaninë e sigurimeve ose në ndërmjetësuesin e sigurimeve, ndalimin e ushtrimit të së drejtës së atij personi për të votuar për aksionet e kompanisë së sigurimeve, ose të kërkojë nga personi të heqë dorë nga interesi pronësor i tij ose saj në kompaninë e sigurimeve.

79.4 Në rast se ndonjë person nuk i shet ose heq dorë prej aksioneve me të drejtë vote të kompanisë së sigurimeve në përputhje me urdhërin e lëshuar sipas këtij neni brenda periudhës kohore të parashkruar, BPK-ja urdhëron që të gjitha aksionet në kompaninë e sigurimeve që mbahen nga ky person t'i kalohen një administratori të besuar për t'i shitur në aukcion dhe të hyrat neto, pa shpenzimet e shitjes, do t'i kthehen atij personi.

80.1 Çdo person i dëmtuar me ndonjë urdhër ose dënim jopenal i lëshuar nga BPK-ja sipas kësaj Rregulloreje mund të kërkojë nga një gjykatë kompetente që ta shqyrtojë atë. Kjo kërkesë duhet të parashtrahet brenda tridhjetë ditësh pasi urdhëri apo dënimi jopenal t'i jetë lëshuar personit. Gjykata ka autorizim për ta konfirmuar, modifikuar ose anuluar në tërësi ose pjesërisht këtë urdhër apo dënim jopenal.

80.2 Në çdo procedurë gjyqësore të një gjykate që ka juridiksion për një urdhër apo dënim jopenal të lëshuar nga BPK në pajtim me këtë Rregullore:

(a) Gjykata mund të refuzojë një urdhëresë ose dënim jopenal nëse konstaton se është lëshuar në kundërshtim me këtë Rregullore ose në kundërshtim me ligjin në fuqi, nëse ka qenë jashtë juridiksionit të BPK-së dhe është lëshuar në kundërshtim me kërkesat e procedurale në fuqi, ose nuk është mbështetur me dëshmi substanciale;

(b) Zyrtari i tashëm apo i mëparshmi, nëpunësi ose agjenti i BPK-së është përgjegjës për dëmet dhe përgjegjës për veprimet apo lëshimet e bëra pa qëllim gjatë punës së tij apo të saj;

(c) Urdhëri apo dënimi jopenal i lëshuar nga BPK, që ka të bëjë me një proces të tillë gjyqësor vazhdon pa kurrfarë kufizimi gjatë procedurës gjyqësore dhe gjatë çdo apelimi apo shqyrtimi gjyqësor që nuk është pezulluar nga një gjykatë apo juridiksion kompetent.

KAPITULLI XII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 81 Dispozitat kalimtare

81.1 Kompania e sigurimeve është “një kompani e pranueshme për UNMIK-un” në kuptimin e nenit 4 të Rregullores nr. 1999/15 të UNMIK-ut të datës 21 tetor 1999 mbi Regjistrimin e Përkohshëm të Automjeteve në Kosovë nëse është licencuar BPK-ja për të bërë sigurimin e palës së tretë nga përgjegjësia, ose nëse është autorzuar të punojë në përputhje me këtë Rregullore.

81.2 Brenda tridhjetë ditësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjitha kompanitë e sigurimeve që janë licencuar sipas Urdhëresës Administrative nr. 1999/3 të UNMIK-ut mbi Zbatimin e Rregullores nr. 1999/15 të UNMIK-ut dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve të cilët ekzistojnë në këtë datë ia paraqesin BPK-së formularin e plotësuar për marrjen e licencës. Secila prej këtyre kompanive të sigurimeve apo ndërmjetësuesve të sigurimeve që nuk paraqiten brenda kësaj kohe, pas kalimit të afatit, pushojnë aktivitetin e tyre dhe vendosen nën administrim ligjor sipas kapitullit mbi Administrimin Ligjor në këtë rregullore. BPK-ja, para skadimit të afatit prej tridhjetë ditëve, dhe për shkaqe të arsyeshme, e zgjatë këtë afat njëherë më së shumti për tridhjetë (30) ditë.

81.3 Pavarësisht nga periudha e aplikimit për licencë të kompanive ekzistuese sipas nenit 82.2, BPK-ja në çdo kohë, për shkaqe të arsyeshme, e urdhëron kompaninë që ta pushojë aktivitetin e saj dhe sipas kapitullit mbi Administrimin ligjor të kësaj Rregulloreje e vendos atë nën administrimin ligjor.

81.4 Brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së pranimit të kërkesës së plotësuar për licencën e një kompanie të sigurimeve apo të ndërmjetësuesit të sigurimeve, BPK-ja në

mënyrë paraprake e miraton ose e refuzon atë dhe e njofton kandidatin me shkrim për vendimin e saj. Çdo kompanie që i është refuzuar kërkesa e pushon menjëherë aktivitetin afarist dhe sipas kapitullit mbi Administrimin ligjor të kësaj Rregulloreje vendoset nën administrimin ligjor.

81.5 Kur BPK-ja jep miratim për një licencë fillestare, ajo i radhitë kushtet sipas të cilave kompania e sigurimeve ose ndërmjetësuesi i sigurimeve duhet të vazhdojë aktivitetin dhe të marrë licencën. BPK-ja mund të anulojë marrjen e licencës preliminare çdo herë kur ajo konstaton se interesi i poseduesve të policave mund të mos përmbushet nëse kompania vazhdon punën.

81.6 Në qoftë se ndonjë kompani e sigurimeve ose ndërmjetësuesi i sigurimeve brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh të vendimit për miratimin fillestar të licencës nuk i përmbush kushtet për marrjen e licencës, skadon miratimi i marrjes paraprake të licencës. BPK-ja mund ta vazhdojë këtë afat për shkak të arsyeshme një herë deri në nëntëdhjetë (90) ditë

81.7 Pas skadimit ose miratimit preliminar të licencës, kompania e sigurimeve ose ndërmjetësuesi i sigurimeve vendoset nën administrim ligjor sipas kapitullit për Administrimin ligjor të kësaj Rregulloreje.

Neni 82
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nxjerr urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 83
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 84
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 5 tetor 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm